



STUDIM

**Veprat penale të torturës,
trajtimit çnjerëzor dhe degradues
si dhe praktika e hetimit dhe
gjyimit të tyre në rrethet
gjyqësore Tiranë dhe Elbasan**



Ky projekt është financuar nga Bashkimi European

Ky publikim është përgatitur në kuadër të Projektit "Së bashku kundër torturës në polici dhe në burgje në Shqipëri", mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Përbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar se reflekton qëndrimin e Bashkimit Evropian.



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**

Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, Papa Gjon Pali II, Kati 17-të,

Telefon: (+355) 4 222 8320 or 223 0871 - 222 8479 - 223 4284

Fax: (+355) 4 223 0752

E-mail: delegation-albania@eeas.europa.eu

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik dhe politik mes 28 vendeve Evropiane. Nënshkrimi i Traktateve të Romës në vitin 1957 shënoi vullnetin e gjashtë vendeve themeluese për të krijuar një hapësirë të përbashkët ekonomike. Që atëherë, në fillim Komuniteti dhe pastaj, Bashkimi Evropian ka vazhduar të zgjerohet dhe të mirëpresë vendet e reja si anëtarë. Ky Bashkim është kthyer në një treg të madh të vetëm me euron si valutë të tij të përbashkët.

Ajo që filloi si një bashkim thjesht ekonomik është zhvilluar në një organizatë që përfshin të gjitha fushat, nga ndihma për zhvillim tek politikat mjedisore. Në sajë të heqjes së kontrolleve kufitare në mes të vendeve të BE-së, tani është e mundur për njerëzit që të udhëtojnë lirshëm brenda në pjesën më të madhe të BE-së. Gjithashtu është bërë shumë më e lehtë për të jetuar dhe punuar në një vend tjetër të BE-së.

Pesë institucionet kryesore të Bashkimit Evropian janë Parlamenti Evropian, Këshilli i Ministrave, Komisioni Evropian, Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Auditorëve. Bashkimi Evropian është një aktor i madh në bashkëpunimin dhe zhvillimin e ndihmës ndërkombëtare. Ai është gjithashtu donatori më i madh i ndihmës humanitare në botë. Qëllimi kryesor i politikës së zhvillimit të BE-së, siç është rënë dakort në nëntor të vitit 2000 është çrrënjësia e varfërisë (<http://europa.eu/>).

Drejtues Pprojekti: Av. Andi Muratej

Përgatitën Studimin: Këshilltar Ligjor Niazi Jaho, M.A. Klejda Ngjela,
Av. Elton Frashëri, Av. Albana Misja

Redaktimi Shkencor: Av. Vjollca Meçaj, Executive Director

Nëse jeni të interesuar për kopje të këtij Studimi, mund të kontaktoni në adresën:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Ap. 10, K. 5, K.P. nr. 1752, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: ++355 (0)4 223 36 71, ++355 (0)69 407 57 32

web address: www.ahc.org.al E-mail: office@ahc.org.al

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesi.

Botues: @ Komiteti Shqiptar i Helsinkit

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
I. BAZA LIGJORE.....	10
1.1 Tortura sipas të Drejtës Ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.....	10
1.2 Traktatet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.....	10
1.3 Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.....	11
1.4 Konventa kundër torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.....	12
1.5 Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut	15
1.6 Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo poshtërues”	16
1.7 Tortura në të drejtën e brendshme.....	17
1.8 Vepra të tjera penale, të ngjashme me Torturën, në të drejtën e brendshme.....	19
II. ANALIZA E DENONCIMEVE HETIMEVE DHE ÇESHTJEVE TE GJYKUARA.....	22
2.1 Raste të ndjekura nga Avokati i Popullit.....	22
2.2 Rreth qëndrimit të mbajtur nga zyra e Avokatit të Popullit rreth rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor, degradues.....	28
2.3 Të dhëna rreth rasteve të trajtuara pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë dhe analiza e tyre.....	31
2.4 Të dhëna rreth rasteve të trajtuara pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan dhe analiza e tyre.....	39
III. ANALIZA E KONCEPTEVE DHE PRAKTIKAVE LIDHUR MES VEPRËS PENALE TË TORTURËS, TRAJTIMIT ÇNJERËZOR APO DEGRADUES.....	48
3.1 Analiza e disa rasteve konkrete, jashtë praktikës hetimore dhe gjyqësore të marrë në studim.....	48
3.2 Paqartësi praktike dhe legjislative lidhur me figurën e krimit të torturës.....	52
3.3 Trajtimi dhe pozicioni i veçantë i viktimës gjatë gjykimit dhe hetimit të veprave penale të torturës.....	56
IV. KONKLUZIONE.....	58
V. REKOMANDIME.....	61

HYRJE

Një ndër të drejtat themelore të njeriut është e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, e cila sanksionohet nga Kushtetutë, legjislacioni penal vendas, si dhe nga neni 3 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Nisur nga kuptimi ligjor e doktrinal i kësaj të drejte, por dhe nga praktika e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), rezulton se kjo e drejtë ngarkon shtetet përkatëse me detyrime pozitive dhe negative. Shtetet kanë detyrimin dhe përgjegjësinë të krijojë, brenda vendit, një sistem efikas për parandalimin e fenomeneve të tilla, të garantojë ndjekjen penale të rasteve të torturës, ose të trajtimit çnjerëzor e degradues, si dhe shqyrtimin gjyqësor, me paanshmëri dhe efikasitet, të çështjeve të kësaj natyre.

Që prej themelimit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) i ka kushtuar vëmendje të veçantë sensibilizimit dhe monitorimit lidhur me respektimin e kësaj të drejte, veçanërisht për shtetasit me liri të kufizuar (të shoqëruarit, të arrestuarit/të ndaluarit, të burgosurit, personat me probleme të shëndetit mendor, ose me paftësi të tjera), për shkak të riskut më të lartë që mbartin lidhur me cënimin e kësaj të drejte. Për këtë qëllim, KShH me inisiativë, ose mbi bazën e ankesave të adresuara, ka organizuar në vazhdimësi monitorime në burgje, paraburgime, komisariate policie dhe spitale psikiatrike, me qëllim verifikimin e respektimit të të drejtave themelore në këto institucione, duke u ndalur veçanërisht në rastet e torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues.

Lidhur me të drejtën për mbrojtjen nga tortura, trajtimi çnjerëzor e degradues KShH është angazhuar të japë kontributin e vet edhe nëpërmjet studimeve; nëpërmjet ndjekjes dhe vlerësimit të praktikave të punës së organeve të drejtësisë; nëpërmjet organizimit të trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë, stafet e policisë së shtetit dhe punonjës të burgjeve e paraburgimeve; si dhe duke përdorur rrugën gjyqësore, për raste konkrete të cënimit të kësaj të drejte.

Ndërhyrjet e mësipërme janë vlerësuar të nevojshme, pasi është vënë re mungesë e ndjeshmërisë së duhur për respektimin e kësaj të drejtë, nga ana e administratës publike, si dhe kuptim jo i saktë dhe jo i unifikuar, mbi këtë institut të së drejtës, nga punonjësit e sistemit të drejtësisë. KShH ka konstatuar se gjatë veprimtarisë së tyre, organet e drejtësisë, kanë manifestuar

si, mungesë të hetimeve të plota; kualifikime të diskutueshme të veprave penale; favorizime të autorëve të akuzuar për vepra të tilla, duke lehtësuar përgjegjësinë e tyre penale; aplikimin e shpeshtë të dënimit nën minimumin e parashkuar në ligj; etj. Nga ana tjetër është konstatuar se ndonëse Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT), Avokati i Popullit, KShH dhe organizata të tjera, vendase dhe të huaja, konstatojnë dhe bëjnë publike shumë shkelje të lirive dhe të drejtave të personave me liri të kufizuar, të cilat përmbajnë elementë të torturës ose trajtimit çnjerëzor e degradues, rastet e ndjekura nga organet e drejtësisë janë tepër minimale.

KShH dëshiron gjithashtu të nënvizojë faktin se, në disa raste, GjEDNJ ka konstatuar shkeljen e nenit 3 KEDNJ nga Republika e Shqipërisë dhe e ka ndëshkuar për këtë shkak.

Nisur nga faktorët e mësipërm, KShH ka marrë inisiativën të realizojë këtë studim, me fokus praktikën e krijuar nga organet e drejtësisë, në kuadër të hetimit dhe gjykimit të veprave penale të torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues, për një periudhë të caktuar kohe¹.

Qëllimi i këtij studimi është analiza e praktikës së punës së organeve të drejtësisë, prokurorisë dhe gjykatave, për sa i takon hetimit dhe gjykimit të rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues dhe nxitja e vendosjes e standarteve ndërkombëtare dhe demokratike, në legjislacion dhe praktikën e organeve të drejtësisë, në mënyrë të veçantë duke i përjasur ato me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut si dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Objekti i këtij studimi është evidentimi i problematikave, në aktet e orgaveve të Prokurorisë dhe të atyre gjyqësore, të rretheve Tiranë e Elbasan, lidhur me kuptimin dhe aplikimin e neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal, duke e krahasuar praktikën e këtyre organeve me standartet që promovon jurisprudenca e GjEDNJ, si dhe vlerësimi i legjislacionit tonë të brendshëm në aspektin e përputhjes së tij me parimet dhe parashikimet substanciale të KEDNJ dhe aktet e tjera ndërkombëtare të kësaj fushe.

Studimi synon që, përveç paraqitjes së situatës lidhur me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit në këtë drejtim, të propozojë përmirësimin e mangësive të konstatuara, sipas standarteve më të mira ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e nivelit të respektimit të kësaj të drejte, si dhe përmirësimin e veprimtarisë së organeve të drejtësisë në këtë fushë.

1 Studimi është kryer në kuadër të Projektit “Së bashku kundër torturës në polici dhe në burgje në Shqipëri”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian

Shteti i së drejtës duhet të krijojë mundësi efektive të qytetarëve për të vënë në vënd çdo të drejtë të shkelur. Në këtë kuadër, merr një rëndësi të veçantë vënia përpara përgjegjësisë dhe ndëshkimi i zyrtarëve dhe punonjësve publikë, të cilët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre shkelin ligjin dhe çënojnë të drejtat themelore të shtetasve. Mosvlerësimi si duhet i fakteve që tregojnë cënim të të drejtës për mbrojtje nga tortura, trajtimi çnjerzor e degradues, hetimi jo i plotë i kallzimeve të bëra, prej organit të akuzës, njëanshmëria e hetimit, ose shqyrtimit gjyqësor, aplikimi i dënimeve jo në përputhje me dëmin që kanë pësuar viktimat dhe interesi publik, janë qëndrime që çënojnë parimet e shtetit të së drejtës, ulin besimin qytetar tek administrata publike, si dhe zhvillimin demokratik të vendit.

Në zbatim të këtij qëllimi dhe në kuadër të nismës së reformës në drejtësi, KSHH vlerëson si të domosdoshme rishikimin cilësor të Kodit Penal dhe të Kodit të Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Çështjet që trajton ky studim, por jo vetëm, janë të rëndësishme për të nxitur diskutime ndërmjet profesionistëve, me qëllim përjasjen, gjithnjë e më të mirë, të legjislacionit tonë me standardet ndërkombëtare demokratike, në mënyrë të veçantë duke i përjasur ato me KEDNj si dhe jurisprudencën e pasur të GjEDNj.

Për realizimin e studimit, punën e kemi fokusuar në disa drejtime. Për ne ishte me interes, së pari, të njihnim praktikën e krijuar nga organet e drejtësisë, në kuadër të hetimit e gjykimit të denoncimeve për torturë dhe trajtim çnjerëzor e degradues. Për këtë qëllim ne kërkuam të njihemi me fashikujt hetimorë dhe veçanërisht me vendimet e prokurorëve të rretheve Tiranë dhe Elbasan, që i përkisnin periudhës 2011-2012, për veprat penale të parashikuara nga nenet 86 "Tortura", 87 "Tortura me pasoja të rënda", 248 "Shpërdorimi i detyrës", 250 Kryerja e veprimeve arbitrare", 314 "Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve" të KP. Siç mund të vihet re e kemi zgjeruar gamën e veprave penale që kemi marrë në shqyrtim, sepse raportet e Avokatit të Popullit, lidhur me fenomenin e torturës, na kishin dhënë sinjale të qarta se, organet e drejtësisë, kryenin kualifikime të gabuara të veprave penale për veprime që kishin elementë të qartë të torturës, ose trajtimit çnjerëzor , degradues. Gjithashtu studiuam dosjet gjyqësore, së bashku me vendimet përfundimtare, dhënë nga shkalla e parë e gjyqësorit dhe Gjykatat e Apelit, në rrethet Tiranë dhe Elbasan, për të njëjtën periudhë. Analiza e rasteve, në këtë studim, është fokusuar edhe në kallëzimet penale të sugjeruara, ose denoncuar nga institucione shtetërore si, Avokati i Popullit dhe organe publike të tjera, të veshura me detyrën funksionale të gjetjes dhe ndjekjes së këtyre rasteve, ose nga organizata jofitimprurëse që veprojnë në këtë drejtim.

Nuk gjetëm asnjë studim, në lidhje me praktikën e hetimit e gjykimit të veprave penale të "Torturës", të kryer nga organet e drejtësisë dhe na rezultoi se Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë vendim unifikues në këtë drejtim, të

cilin mund ta kishim mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të studimit tonë. Megjithatë u përdorën standardet e pjesëshme, të krijuara nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 11.02.2004.

Metodologjia . Në këtë studim është trajtuar gjërësisht kuptimi dhe elementet përbërës të veprës penale të torturës, porë si nga këndvështrimi doktrinal, legjislacioni i brendshëm, ligjet vendase penal e procedurial penal, KEDNJ dhe akte të tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Gjithashtu, në këtë drejtim, është mbajtur parasysh dhe jurisprudenca e GJEDNJ, e cila ka trajtuar gjërësisht elementët përbërës të cënimit të të drejtës për mbrojtje nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor degradues, si edhe parimet dhe standartet e tjera ndërkombëtare të krijuara në këtë fushë.

Veç sa më sipër, puna studimore është kryer duke zbatuar elementë të metodologjisë që shrytëzojnë aspekte të praktikës së krijuar nga organet e drejtësisë, organet të ndryshme ligjzbatuese, si dhe të organeve që mbikëqyrin respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Studimi përmban dhe analizë të gjetjeve kryesore, duke përfunduar në konkluzione e rekomandime, konkrete, për përmirësimin e situatës në këtë drejtim.

Nga pikëpamja e shtrirjes studimi përfshin veprimtarinë e kryer pranë Prokurorive dhe Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Elbasan dhe Tiranë, për periudhën kohore të viteve 2011-2012 dhe më gjerë. U analizuan statistikat, aktet e dosjeve penale të 649 kallëzimeve dhe 338 procedimeve penale dhe u studiuuan të gjitha dosjet gjyqësore, për akuzat e sipërshënuara, të shqyrtuara gjatë viteve 2011-2012 nga gjykatat e Tiranës dhe Elbasanit. Në mënyrë të veçantë u analizuan rreth 200 vendime të prokurorëve dhe gjyqtarëve të këtyre rretheve.

Studimi i dosjeve është paraprirë nga një punë përgatitore me grupin e ekspertëve, të cilët si njohës të mirë të fushës, përcaktuan drejtimet kryesore ku duhej të përqëndrohej vëmendja gjatë studimit të akteve të prokurorisë dhe të gjykatave, që do të merreshin në shqyrtim.

Gjithashtu, ky studim mban në konsideratë dhe mendimet e shprehura, rreth kësaj teme, nga ekspertë të fushës, gjyqtarë dhe prokurorë, gjatë një seance për trajnim vazhdues, të zhvilluar pranë Shkollës së Magjistraturës, në kuadër të zbatimit të projektit nga KShH.

Politika penale e ndjekur nga organet e drejtësisë ndaj torturës, trajtimit çnjerëzor, degradues, për rrethet Tiranë dhe Elbasan, për vitet 2011-2012, është parë e krahasuar me situatën e përhapjes së këtyre fenomeneve negative, që rezulton nga raportet e organizmave, vendase dhe ndërkombëtare, që e monitorojnë këtë situatë.

Për t'iu përgjigjur nevojës për njohuri specifike në fusha të ndryshme të së drejtës, përveç stafit të KshH janë angazhuar dhe specialistë të fushës procedurale penale, asaj kushtetuese, si dhe ekspertë me praktikë të gjerë pranë GJEDNJ.

Gjejmë rastin të falenderojmë kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë z. Fatri Islamaj, kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan z. Arben Vrioni, drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë z. Petrit Fusha dhe drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan z. Eugen Beci, si dhe stafin e administratës së këtyre institucioneve, të cilët na dhanë akses në të gjitha dosjet për të cilat kishte interes studimi.

Falenderojmë gjithashtu, stafin e Avokatit të Popullit, për bashkëpunimin që na ofruan, si dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, donatorin që mbështeti dhe mundësoi financiarisht kryerjen e këtij studimi.

I. BAZA LIGJORE

1.1 Tortura sipas të Drejtës Ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë

Shtrirja e detyrimeve të Shteteve për parandalimin e torturës, ashtu sikundër për shumë liri dhe të drejta themelore të njeriut, varet gjërësisht nga traktatet ndërkombëtare dhe organet që i interpretojnë ato. Standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e kësaj të drejte i gjejmë të trajtuara gjërësisht nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Komiteti kundër Torturës, të cilët interpretojnë detyrimet e Shteteve sipas Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventës kundër Torturës. Për Shtetet palë këto organe mund të marrin në shqyrtim ankesa nga individë që pretendojnë cënim të të drejtës së tyre. Komitetet nuk janë gjykata por trupa pothuajse-gjyqësore, që nënkuptojnë që vendimet e tyre, megjithëse janë të rëndësishme për interpretimin e traktateve, nuk janë drejtëpërdrejt ligjërish të zbatueshëm. Ekzistojnë edhe tre sisteme rajonale për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në Europë, në Amerikë dhe në Afrikë. Të tre sistemet kanë adoptuar një mekanizëm dy-organesh për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që përbëhet nga një Komision i cili është një trup pothuajse-gjyqësor me të drejtën për të nxjerrë vendime dhe rekomandime si dhe një Gjykatë me të drejtën për të nxjerrë vendime ligjërish të zbatueshme.

1.2 Traktatet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara²

Ndalimi i torturës në të drejtën ndërkombëtare, sikurse ndalimi i skllavërisë dhe genocidit, ka karakter absolut. Tortura është e palejuar në asnjë rrethanë, duke përfshirë luftën, urgjencën publike apo kërcënimet terroriste. Ndalimi absolut i gjithëpranuar i torturës përbën një parim themelor të së drejtës ndërkombëtare.

Në rend kronologjik, pas Luftës së Dytë Botërore, **Deklarata Universale**

² Republika e Shqipërisë është pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në dt. 14 Dhjetor 1955

për të Drejtat e Njeriut³ përbën aktin e parë ndërkombëtar që shprehej mbi ndalimin e torturës. Konkretisht në nenin 5 shprehet se: *"Asnjë person nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues."*

Brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara, ndalimi i torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues është shprehimisht i ndaluar në bazë të një numri traktatesh të cilat janë ligjërisht të detyrueshme për Shtetet që i kanë ratifikuar. Shumë traktate krijojnë Komitete të cilat janë të mandatuara për të monitoruar pajtueshmërinë e Shteteve Palë me obligimet e këtyre Traktateve duke lëshuar Komente të Përgjithshme apo Rekomandime, të cilat parashikojnë interpretime të detajuara mbi aspekte specifike të traktatit.

1.3 Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike⁴

Kjo Konventë sanksionon shprehimisht ndalimin e torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, me synim për të mbrojtur njëkohësisht dinjitetin, integritetin fizik dhe mendor të individëve. Neni 7, i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, parashikon se: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Në mënyrë të veçantë, asnjë nuk mund t'i nënshtrohet pa pëlqimin e tij të lirë një eksperimenti mjekësor apo shkencor."*

Sipas një Komenti të Përgjithshëm⁵, Komiteti për të Drejtat e Njeriut nuk e ka konsideruar të nevojshëm të përcaktonte një listë të akteve të ndaluara ose për të vendosur dallim të prerë midis torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit, pasi këto *"dallime varen nga natyra, qëllimi dhe rëndësia e trajtimit të aplikuar"*. Përcaktimi i një trajtimi si shkelje e nenit 7 do të varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja dhe mënyra e trajtimit, efektet fizike dhe mendore të trajtimit si dhe seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Elementë si mosha apo gjendja mendore mundet që të përkeqësojnë efektet e një trajtimi të caktuar duke çuar në shkelje të nenit 7.

Fjalja e dytë e Neni 7 që ka të bëjë me ndalimin e eksperimentit mjekësor apo shkencor, pa pëlqimin e personit ishte një përgjigje ndaj mizorive të kryera nga doktorët në kampet e përqendrimit nazist gjatë Luftës së II Botërore. Në

3 Miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) me rezolutën e saj 217 A (III) të 10 Dhjetor 1948

4 Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me rezolutën e saj 2200 A (XXI) më 16 Dhjetor 1966 dhe hyrë në fuqi më 23 Mars 1976. Republika e Shqipërisë e ka miratuar me Ligjin nr. 7510, dt. 08.08.1991

5 "Tortura në të Drejtën Ndërkombëtare - Një guide në jurisprudencë", APT, CEJIL, 2008, Kapitulli 1, faqe 7

këtë vështrim, mbrojtja e veçantë është për personat që nuk janë në gjendje të japim pëlqim të vlefshëm, veçanërisht, ato të privuar nga liria, të cilët nuk duhet të jenë subjekt i ndonjë eksperimenti mjekësor apo shkencor i cili mund të jetë i dëmshëm për shëndetin e tyre.

Ndërsa neni 10, pika 1, e Konventës ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike thotë: *"Të gjithë personat e privuar nga liria, duhet t'ju trajtohen me humanizim dhe respekt për dinjitetin lindur të njeriut"*, duke vendosur ndalimin e torturës dhe të keqtrajtimit për ato persona që janë të privuar nga liria. Jo vetëm që këto persona nuk mund të trajtohen në kundërshtim me nenin 7, por ato kanë të drejtën pozitive të trajtohen me respekt.

Ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit sipas kësaj Konvente aplikohet pavarësisht nëse veprimet janë kryer nga *"zyrtarë publikë"* apo *"persona të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit"* apo *"persona privatë"* dhe *"nëse inkurajojnë, urdhërojnë, tolerojnë apo kryejnë akte"*. Kështu, **ndalimi i keqtrajtimit nuk krijon thjesht një detyrim negativ për punonjësit e shtetit që të mos përfshihen në një trajtim të tillë. Shteti ka edhe detyrimin pozitiv të mbrojë personat e ndodhur në juridiksionin e tij nga veprime të torturës të kryera nga individë privatë.**

1.4 Konventa kundër torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues⁶

Konventa kundër torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues përbën aktin specifik ndërkombëtar që tenton të përkufizojë torturën. Neni 1, pika 1 sanksionon se: *"Për qëllimet e kësaj Konvente termi "torturë" nënkupton çdo veprim me të cilin personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhembje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhembjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhembjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre."*

Në Nenin 16, kjo Konventë kërkon nga Shtetet palë të parandalojnë *"veprime*

⁶ Miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me rezolutën e saj 39/46 më 10 Dhjetor 1984 dhe hyrë në fuqi më 26 Qershor 1987. Republika e Shqipërisë aderoi në Konventën kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese me ligjin nr. 7727, datë 30.06.1993, shpallur me dekretin nr. 592, datë 06.07.1993 të Presidentit të Republikës. Konventa hyri në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 11 maj 1994

të tjera që përbëjnë dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, që nuk janë veprime torture, siç është përcaktuar kjo në nenin 1, kur veprime të tilla janë kryer nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër që vepron me titull zyrtar, ose me nxitjen e tij ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur..." Megjithëse Konventa nuk parashikon përkufizime për veprime që kualifikohen si dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, **lë të nënkuptohet se veprimet që nuk përfshihen në kuptimin e torturës do t'i përkasin kësaj kategorie më të lehtë.**

Konventa përcakton shprehimisht në nenin 2 të saj se, nuk ka asnjë rrethanë të veçantë, nën të cilën një shtet mund të përdorë torturën apo veprime të tjera që përbëjnë dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, pa cënuar detyrimet që rrjedhin nga traktati, duke ritheksuar kështu **karakterin absolut të këtij ndalimi.** Për të ndikuar në parandalimin efektiv të torturës dhe keqtrajtimeve të tjera, neni 15 i Konventës thekson se, çdo tendencë për përdorimin e një abuzimi të tillë, me qëllim që të ndihmohen hetimet për vepra të kundraligjshme duhet të eliminohet sepse pranimi i deklarimeve të bëra nën një trajtim të tillë, në çdo rast, nuk janë të besueshme dhe prandaj ato duhet të ndalohen me ligj.

Një element i përbashkët i torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo degradues, sipas kësaj Konvente është që në këto veprime të jetë përfshirë një zyrtar publik apo dikush që vepron në kuadër të pozitës zyrtare. Megjithatë, për qëllime të kësaj Konvente, trajtimi mizor, çnjerëzor apo degradues mund të mos klasifikohet si "torturë", për shkak se nuk kërkon qëllim si tek tortura dhe/ose dhimbja dhe vuajtja nuk është "e rëndë" sipas kuptimit të Nenit 1.

Qëllimi i përmendur shprehimisht në Nenin 1 nuk përbën një listë shteruese pasi togfjalëshi "*me qëllim që*" tregon që mund të përfshihen edhe qëllime të tjera të ngjashme. Elementi i përbashkët i këtyre qëllimeve mund të kuptohet më mirë si "*disa lidhje me interesin e policisë së Shtetit dhe organeve të tij*".⁷

Sipas kësaj Konvente, për të kualifikuar torturën, ose trajtimin mizor, çnjerëzor apo degradues, *së pari*, dhimbja apo vuajtja duhet të shkaktohet me veprimin, nxitjen, pëlqimin ose pranimin në heshtje të zyrtarit publik apo nga persona të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit. Kjo kërkesë do të thotë që Shtetet nuk mund të jenë përgjegjëse nëse veprimet e torturës apo trajtimeve çnjerëzore, mizore ose degraduese do të kryhen nga persona jashtë kontrollit apo autoritetit të tyre. *Së dyti*, Shtetet mund të gjenden përgjegjëse për veprimet e torturës apo trajtimeve çnjerëzore, mizore ose degraduese nga individë privatë në territorin e tyre nëse ata dështojnë të marrin masa të

7 Burgers and Danelius, *The United Nations Convention against Torture*, Martinus Nijhoff, Dordrecht, 1988, p.119

përgjithshme apo specifike për parandalimin e ushtrimit të dhunës prej tyre.

Përveç detyrimit për të hetuar dhe dëmshpërblyer rastet e torturës apo trajtimit çnjerëzor ose degradues, sipas Konventës të sipërpërmendur dhe Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Shtetet palë kanë detyrimin për të miratuar dhe zbatuar legjislacionin që kriminalizon këto vepra. Konkretisht në nenin 4 të Konventës kundër Torturës, Dënimit apo Trajtimit Çnjerëzor apo Degradues sanksionohet se: *"1. Çdo shtet palë siguron që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen vepra penale nga ligji i tij penal. E njëjta gjë vlen për tentativën për ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim. 2. Çdo shtet palë do të japë dënime përkatëse për këto vepra penale duke marrë parasysh seriozitetin e tyre."*

Pothuajse të njëjtën sanksionim ka bërë edhe Koventa mbi të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 2 të saj, ku thuhet se: *"2. Çdo shtet palë i kështij Pakti zotohet, në përputhje me procedurat e tij kushtetuese dhe me dispozitat e kështij Pakti, të marrë hapa të nevojshëm të cilët do të lejojnë marrjen e masave të tilla legjislative ose të masave të tjera të nevojshme që të mund të zbatohen drejtat e njohura në këtë Pakt, nëse masa të tilla ende nuk janë parashikuar."*

Një aspekt të rëndësishëm mbi juridiksionin universal, si një kapacitet normativ për të hetuar dhe gjykuar rastet e torturës, parashikon neni 5 i Konventës kundër torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues: *"1. Çdo shtet palë merr masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e përmendura në nenin 4, në raste e mëposhtme: (a) Kur veprat penale kryhen në cilindo territor nën juridiksionin e vet ose në anije apo aeroplan të regjistruar në atë shtet, (b) Kur kryerësi i supozuar është shtetas i atij shteti, (c) Kur viktima është shtetas i atij shteti, në qoftë se ky shtet konsideron se një gjë e tillë është e përshtatshme. 2. Çdo shtet palë merr gjithashtu masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e sipërpërmendura në rastin kur kryerësi i supozuar i tyre ndodhet në cilindo territor nën juridiksionin e tij dhe kur shteti në fjalë nuk e ekstradon në përputhje me nenin 8, në ndonjërin nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. 3. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë kompetencë penalo-juridike që ushtrohet në përputhje me ligjet e një vendi."*

Në këtë vështrim, Koventa kërkon që Shtetet palë të ushtrojnë juridiksionin e tyre, duke ndjekur penalisht një individ të dyshuar për torturë apo trajtime çnjerëzore, mizore ose degraduese ose ta ekstradojnë atë në vendin ku ai do të ndiqet penalisht.

1.5 Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut⁸

Kjo është një tjetër konventë ndërkombëtare e rëndësishme e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe që vepron në kuadrin rajonal evropian, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në nenin 3 të saj sanksionohet se: “*Askush nuk duhet të jetë subjekt i torturës apo i trajtimit çnjerëzor ose degradues*”. Nga analiza gramatikore dhe logjike e dispozitës dhe jurisprudencës së gjerë të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) rezulton se termat *torturë*, *trajtim çnjerëzor* dhe *degradues* ndryshojnë dhe kanë konotacion të dallueshëm nga njëri-tjetri.

Me *torturë* kuptohet përdorimi i dhunës fizike apo psikike *për qëllime* dënimi ose për të nxjerrë një informacion, etj. *Trajtimi çnjerëzor* nënkupton shkaktim me dashje të vuajtjeve fizike dhe mendore mbi trupin dhe emocionet e qenieve njerëzore, pa pasur domosdoshmërisht një qëllim të posaçëm. Ndërsa me *trajtim degradues* do të kuptohet privimi i individit prej dinjitetit të tij, akte që çojnë në dekadencë morale dhe intelektuale.⁹ Trajtimi i personit fizik, për tu konsideruar në kundërshtim me nenin 3 të KEDNj-së, **duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie, duke marrë në analizë kohëzgjatjen, moshën e viktimës, gjininë, gjendjen shëndetësore dhe efektet fizike apo mendore që pëson viktimja, si dhe çdo rrethanë tjetër specifike të situatës.** Aktet konkrete të dhunës që mund të cilësohen në çenim të nenit 3 të KEDNj-së nuk janë shpëruese, ato janë të shumëllojshme dhe varen nga rrethanat konkrete të ngjarjes.

Kjo dispozitë mbron marrëdhëniet juridike të vendosura për jetën, shëndetin dhe dinjitetin e njeriut. Ajo ndalon kryerjen e torturës, trajtimit çnjerëzor apo degradues nga çdo person zyrtar dhe individ privat. Pra, subjekti i këtyre veprave është i posaçëm dhe i përgjithshëm.

Sikuese aktet e mësipërme ndërkombëtare, KEDNj i jep një **karakter absolut** këtij ndalimi, si një standart universal dhe gjithëkohor. Neni 3 i KEDNj-së është absolut pavarësisht nga sjellja, apo rrethanat e viktimës, natyrës së ndonjë vepre, ose kërcënimi ndaj sigurisë kombëtare.¹⁰

⁸ Miratuar me Ligjin nr. 8137/ 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”

⁹ Referat i z.Arben Rakipi, mbajtur gjatë trajnimit me gjyqtarë e prokurorë në Dhjetor 2014 në Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të veprimtarisë së KShH, bazuar në projektin financiar nga BE, mbi Torturën

¹⁰ Referat i znj. Elira Kokona, mbajtur gjatë trajnimit me gjyqtarë e prokurorë në Dhjetor 2014 në Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të veprimtarisë së KShH, bazuar në projektin financiar nga BE, mbi Torturën

KEDNJ-ja është një e drejtë e “gjallë” për shkak të dinamizmit dhe fuqisë detyruese të jurisprudencës së GjEDNJ-së. Nga praktika e gjerë e kësaj gjykate, rezulton se shtetet:

- a) Nuk duhet të përdorin nëpërmjet agjentëve të tyre, torturë, trajtim apo dënim çnjerëzor ose degradues, si një detyrim negativ i shteteve;
- b) Duhet të sigurojnë mbrojtje të shtetasve ndaj trajtimeve të tilla nëpërmjet zhvillimeve legjislative, institucionale dhe organizative, si dhe
- c) Duhet të hetojnë akte të tilla, si detyrim pozitiv i shteteve.

Në këtë kuptim, shteti, në çdo rrethanë, jo vetëm që nuk duhet të përdorë forcën e tij për të shkaktuar torturë, trajtim apo dënim çnjerëzor ose degradues, por duhet të marrë çdo masë për parandalimin ose hetimin e gjykimin e personave, qoftë edhe individë privatë që shkaktojnë trajtime të tilla.

Jurisprudenca e GjEDNJ-së ka konkluduar se hetimi i akteve të tilla në cënim të nenit 3 duhet të jetë efektiv, duke plotësuar disa kriterë si:

- a) Hetimi duhet të shtrihet në kohë për mundësimin e zbulimit, ruajtjes dhe identifikimin e provave dhe autorëve;
- b) Duhet të mbledhë të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve dhe personelin e zbatimit të ligjit, provat mjeko-ligjore dhe të përfshijë kryerjen e një ekspertize mjekësore, që siguron një regjistrim të plotë dhe të saktë të lëndimit;
- c) Gjykimi i shpejtë i autorëve dhe,
- d) Sigurimi i një qasje të arsyeshme për hetimin e pretendimeve të viktimës apo të afërmeve të tij.¹¹

1.6 Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo poshtëruës”¹²

Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo poshtëruës është një tjetër akt ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Konventa parashikon krijimin e një komiteti i cili ka kompetencën të

11 Cështja Boicenco vs Moldavo, nr. 41088/05, më 11 Qershor 2006

12 Miratuar me Ligjin nr. 8135, datë 31.7.1996, “Për aderimin në “Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues”

vizitojë, vendet e privimit nga liria nën administrimin e autoriteteve publike. Komiteti mund të bëjë rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e gjëndjes si dhe për mbrojtjen e personave të privuar nga liria nga tortura dhe trajtimi apo dënimi çnjerëzor dhe poshtëruës. Ky komitet përbëhet përbëhet nga ekspertë dhe veprimtaria e tij ka karakter parandalues dhe jo-gjyqësor.

Komiteti për Parandalimin e Torturës ka zhvilluar në Shqipëri 11 vizita, periodike apo *ad-hoc*. Rekomandimet e Komitetit kanë shërbyer si një shtysë e rëndësishme për evidentimin e shkeljeve si dhe marrjen e masave për përmirësimin e respektimit të të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar, të burgosur apo të vendosur në spitale psikiatrike.

1.7 Tortura në të drejtën e brendshme

Si akti me fuqinë më të lartë juridike në vend, **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, në nenin 25 sanksionon se: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës"*. Përmbajtja e saj është pothuajse e njëjtë me nenin 3 të KEDNj-së, duke pasur karakteristika të një dispozite të bardhë.

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ndonëse i miratuar para Kushtetutës, në Seksionin III, nenin 86, të titulluar **"Tortura"**, përcaktohej: *"Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet"*, duke i dhënë kësaj dispozite natyrën e dispozitës së "bardhë" që nuk jep përkufizim apo detajim të koncepteve juridike të përfshira në të. Ndërsa, në nenin 87, të këtij Ligji nën titullin **"Tortura me pasoja të rënda"**, parashikon se *"Tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përherëshëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet"*.

Nga nevoja për t'i dhënë përkufizimet e nevojshme dispozitës dhe zgjerimin e saj me konceptet e zhvilluara në jurisprudencën e pasur të GjEDNj-së, me **Ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007 dhe me Ligjin Nr. 23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"**, neni 86 **"Tortura"** është ndryshuar si vijon: *"Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim: a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime; b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër; c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër; ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi; d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës; - dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet"*. Gjithashtu, në nenin 5/2, të **Ligjit nr. 7905, dt. 21.03.1995, "Kodi i Proçedurës**

Penale i Republikës së Shqipërisë”, me qëllim për të parandaluar çdo lloj keqtrajtimi ndaj personave nën akuzë, thuhet se: *“Askush nuk mund të nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtëruës”*.

Me anë të këtyre ndryshimeve është plotësuar detyrimi parimor i së drejtës Penale *“Nulla poena sine lege”*, parashikuar në nenin 2, të Kodit Penal¹³. Dispozita aktuale e ndalimit të torturës është e plotësuar me elementë objektivë dhe subjektivë duke bërë të mundur që të jetë e aplikueshme lehtësisht nga organet e hetimit dhe gjykimit.

Nga analiza e kësaj dispozitë rezulton se, ndër të tjera tortura dallon nga aktet çnjerëzore dhe poshtëruese sepse kërkon qëllimin e posaçëm, pavarësisht se kjo analizë nuk shërben për kualifikimin e veprës penale por vetëm për masën e dënimit. Për më tepër, nga mënyra e ndërtimit të dispozitës, pika d) *“çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës”* konsiderohet si një nga qëllimet e mundshme të konsumimit të veprës penale të torturës dhe jo si figurë të një veprë penale më vete. Gjithashtu, element tjetër i dispozitës është subjekti i posaçëm i parashikuar nga neni 86, i cili saktëson se veprimet e ndaluara duhet të jenë kryer *“nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij...”*. **Duket qartë që legjislacioni ynë nuk reflekton jurisprudencën e GjEDNj-së në këtë drejtim**, sepse ajo Gjykatë, praktika e të cilës është e detyrueshme për autoritetet tona, shprehet se **shteti ka detyrimin e parandalimit apo ndëshkimit të autorëve të torturës, trajtimit apo dënimit çnjerëzor, ose poshtëruës, edhe ndaj individëve që nuk janë nën kontrollin e tij**.

Ndonëse neni 86, i Kodit Penal titullohet *“Tortura”*, dispozita lë të hapur dhe përfshin edhe elementë të tjerë të figurës së veprës penale (*shih shkronjën “d” të nenit më sipër*) dhe nuk përmban elementët e intensitetit të dhunës së ushtruar ose elementë të tjerë të cilët trajtohen në faqen 8 të këtij studimi. Për të qëndruar në koherencë dhe për të reflektuar jurisprudencën e GjEDNj-së, neni 86 mund të përmbante, në mënyrë taksative, elementin e **intensitetit** si dhe **nivelin minimal të ashpërsisë**, duke marrë në analizë **kohëzgjatjen, moshën e viktimës, gjininë, gjendjen shëndetësore dhe efektet fizike apo mendore që pëson viktimja si dhe çdo rrethanë tjetër specifike të situatës**.

Dispozita aktuale përfshin si kusht të domosdoshëm, *“shkaktimin e vuajtjeve të rënda, fizike apo mendore...”*, edhe pse qëllimi për *“çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtëruës”* nuk kërkon pasoja të tilla po aq të rënda për kualifikimin e veprës. Kjo sjell nevojën e rregullimit të dispozitës për të bërë dallimin e

13 Referat i z.Arben Rakipi, mbajtur gjatë trajnimit me gjyqtarë e prokurorë në Dhjetor 2014 në Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të veprimtarisë së KShH, bazuar në projektin financiar nga BE, mbi Torturën

qartë midis torturës dhe akteve të tjera çnjerëzore ose poshtëruese, për efekt të kualifikimit të veprimeve të caktuara me rrezikshmëri shoqërore dhe masës së dënimit përkatës.

Pajtueshmëria e neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të detyrueshme për Shqipërinë ka qenë pjesë e arsyetimit të **Vendimit nr. 3, datë 11.02.2004, të Gjykatës Kushtetuese Shqiptar**. Në këtë vendim, ajo Gjykatë ka theksuar se, **si në jurisprudencën ndërkombëtare, ashtu edhe në doktrinën juridike është i pakundërshtueshëm fakti se shteti duhet të sigurojë mbrojtjen e çdo individi nga personat që veprojnë në emër të shtetit, ose individ privat, pasi e rëndësishme mbetet parandalimi i torturës dhe trajtimet çnjerëzore për cilindo** dhe jo cili do të ndëshkohet për kryerjen e këtyre veprave. Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, nenit 1 të Konventës Kundër Torturës të Dhjetorit 1984, si dhe praktikës së GjEDNj argumenton në mënyrë bindëse se, vepra e torturës (kur vërtetohet) kryhet *“jo vetëm nga persona që veprojnë me kapacitet zyrtar por edhe jashtë këtij kapaciteti, pra edhe nga persona private”*.

1.8 Vepra të tjera penale, të ngjashme me Torturën, në të drejtën e brendshme

Me qëllim që ky studim të jetë sa më i plotë e i gjithanshëm, në aspektin e hetimit dhe gjykimin të rasteve të mundshme të torturës, duhet të përfshihen në trajtim dhe vepra të tjera penale, që përmbajnë elementë të ngjashëm, të cilët mund të ndikojnë në cilësim të gabuar juridik të veprave nga organet e ndjekjes penale dhe të gjykimin.

Vepra penale e torturës është parashikuar në nenin 86 dhe 87, të KP, të cilët janë vendosur në Pjesën e Posaçme, Kreu II, Seksioni III “Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit”, të Kodit Penal.

Në të njëjtin seksion, në nenin 90, është parashikuar vepra penale “Dëmtime të tjera me dashje”, me përmbajtje si vijon: *“Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundëroajtje penale dhe dënohen me gjobë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundëroajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”*. Nga një vështrim i kësaj dispozite rezulton se ajo parashikohet si një vepër penale e lehtë, me subjekt aktiv të përgjithshëm. Pavarësisht se vepra penale, sipas kësaj dispozite, mund të bëhet objekt shqyrtimi nga gjykata vetëm me nismën e të dëmtuarit akuzues, përdorimi i rrahjes dhe çdo vepre tjetër dhune mund të jetë ushtruar në atë masë, formë, intensitet, etj., sa që mund të cilësohej, eventualisht, si rrethana e anës objektive të figurës së veprës penale të Torturës.

Vepra penale si “Shpërdorimi i detyrës”, “Kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve”, të parashikuara në Kreun VIII, Seksioni II, të Kodit Penal, ku trajtohen “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”, në dukje përmbajnë elementët që mund të kenë ngjashmëri me elementët e figurës së veprës penale të Torturës¹⁴.

Neni 248 i KP sanksionon se: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mos përmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”. Neni 250 i KP parashikon “Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet”. Ndërsa, në nenin 314 KP sanksionohet se “Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.

Nga një analizë e elementëve objektivë dhe subjektivë të këtyre veprave penale krijohet përshtypja se mund të ketë paqartësi të organeve të hetimit dhe gjykimit lidhur me cilësimin juridik të veprës, përfshirë dhe torturën, aq më tepër kur as praktika gjyqësore dhe as doktrina e të drejtës Penale vendase nuk ka trajtuar me hollësi elementët dallues midis këtyre veprave penale. Respektivisht, “dashja në kryerjen e veprimeve, apo mosveprimeve, në kundërshtim me ligjin...nga personi me funksione publike..., të cilët kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetasve...”, apo “kryerja e veprimeve ose dhënie e urdhërave arbitrare...punonjës me funksion shtetëror apo publik...”, ose “përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve...detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri..”, të parashikuara në veprat përkatëse, mund të jenë elementë të anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale të Torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues (neni 86 dhe 87). Kjo nxjerr në dukje dhe një problem tjetër të legjislacionit penal i cili ka pësuar zhvillime të përsëritura, duke shtuar dispozita të reja, pa vlerësuar tërësisht veprat penale ekzistuese dhe pa u kujdesur që midis tyre të mos krijohet konfuzion.

Veçanërisht, neni 314 i Kodit Penal përthithet plotësisht nga nenet 86 dhe 87, të Kodit Penal.

14 Kupto: nenet 248, 250, 314 të Kodit Penal

Veçanërisht, konfuzioni midis veprave penale sipas Kodit Penal dhe Kushtetutës si dhe KEDNj vjen nga fakti se ato dispozita kanë hyrë në fuqi përpara miratimit të këtyre të fundit duke mos marrë parasysh standardet që vendosnin këto akte. Ndryshimet e mëvonshme në Kodin Penal nuk plotësuan standardet e vendosura nga jurisprudencës së GjEDNj, në zbatim të KEDNj.

II. ANALIZA E DENONCIMEVE HETIMEVE DHE ÇESHTJEVE TE GJYKUARA

2.1 Raste të ndjekura nga Avokati i Popullit

Zgjedhëm ta nisim këtë analizë, lidhur me ndjekjen penale të ushtruar ndaj torturës, trajtimit çnjerëzor, ose degradues, me informacione që vijnë nga veprimtaria e Avokatit të Popullit, sepse për misionin që ka, ky organ kushtetues, ofron një burim informacioni të pasur lidhur me ankesat që kanë shtetasit për sjellje të dhunshme, të ushtruar nga funksionarët publikë, gjatë ushtrimit të detyrës. Nga njohja me Raportet Vjetore të Avokatit të Popullit për v. 2010- 2012 rezulton se, nga ankesat e marra, ky institucion ka verifikuar disa raste ku pretendohet ushtrim i paligjshëm i dhunës. **Përfundimisht, ky institucion ka paraqitur shumë rekomandime pranë organeve të Prokurorisë, për ndjekjen penale ndaj funksionarëve publikë, që dyshohen se kanë konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 86, i Kodit Penal.** Zgjedhëm ta nisim analizën me informacionin që vjen nga Avokati i Popullit sepse është struktura e parë publike që ka ngritur zërin ndaj kualifikimeve të gabuara që organet e drejtësisë u bëjnë rasteve të ushtrimit të dhunës, në dëm të shtetasve, nga funksionarë publikë, gjatë ushtrimit të detyrës. Ky ishte dhe një nga faktorët që na nxiti ta ndërmarrim këtë studim.

Referuar Raporteve Vjetore të sipërcituar, por dhe nga shqyrtimi i vendimeve që na vuri në dispozicion Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konstatojmë se, organi i akuzës u ka bërë kualifikim të ndryshëm ligjor veprave penale të reomanduara nga Avokati i Popullit, ndonëse pranë këtij institucioni vepron Mekanizmi Kombëtar Kundër Torturës, një strukturë e specializuar në fushën e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, me lidhje direkte me Komitetin për Parandalimin e Torturës, një strukturë ndërkombëtare që vepron në këtë fushë.

Gjithashtu, duke iu referuar raporteve të AP, në mënyrë të përmbledhur po parashatrojmë, në vijim, katër raste të trajtuara e sugjerua për ndjekje nga ky institucion:

1. Një shtetasi i ishte bërë thirrje për të ndaluar në rrugë nga një punonjës policie. Ankuesi, ndonëse i është bindur urdhërit, është lidhur me pranga dhe është keqtrajtuar nga disa punonjës policie, të pranishëm, të cilët më pas e kanë shoqëruar në Komisarlatin nr 2 Tiranë, ku pretendohet se kishte vazhduar keqtrajtimi i tij. Nga goditjet e forta, ai ka humbur ndjenjat dhe i ka rënë të fikët. Sapo është përmëndur, punonjësit e policisë e kanë goditur përsëri, deri sa ai humbiste ndjenjat dhe kjo skenë është përsëritur disa herë. Më pas, ai është dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe është izoluar në dhomat e paraburgimit të këtij organi. Në këto ambiente ai është vizituar dhe mjekuar nga mjeku i policisë.

Eksperti mjeko-ligjor konstatoi shenja të dukshme dhune në kokë, fytyrë dhe në pjesë të tjera të trupit. Gjithashtu, nga ekspertët u bë kqyrja e dokumentacionit të policisë, ku ishin pasqyruar vizitat mjekësore që i ishin bërë ankuesit nga mjeku i policisë. Në përfundim të hetimit të kësaj ankese dhe nga provat e administruara rezultoi se, pretendimet e ankuesit për keqtrajtim fizik, nga punonjësit e policisë, ishin të vërteta. Gjithashtu u identifikuan dy nga punonjësit e policisë, A.Gj. dhe K.B., që kishin kryer veprimet e kundërligjshme ndaj ankuesit. Për këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë, për veprën penale të "Torturës", parashikuar nga neni 86 dhe 25 i K.Penal, i ndryshuar.

Në Vendimin Tomasi kundër Francë, të dt. 27 Gusht 1992, të GjEDNj, pohohet se: "Megjithëse dëmtimet e viktimës mund të duken relativisht të lehta, ato përbëjnë shenja të jashtme të përdorimit të dhunës, të forcës fizike ndaj personit të cilit i është hequr liria, pra është në gjëndje inferiore. Ky trajtim ka karakter çnjerëzor dhe poshtërues....Raportet dhe çertifikatat mjekësore të hartuara nga mjekë, në pavarësi të plotë, vërtetojnë dendësinë dhe goditjet e shumta, që përbëjnë dy elementë mjaft të rëndësishëm, të cilat i japin këtij trajtimi karakter çnjerëzor dhe poshtërues".

Në rastin e mësipërm ndodhemi në një situatë thuajse të njëjtë kur shenjat e dhunës (në kokë, fytyrë dhe në pjesë të tjera të trupit) ndaj një shtetasi janë konfirmuar edhe nga ekspertët mjeko-ligjorë që kanë vizituar viktimën.

2. Katër shtetas, përkatësisht B. K., M. K., J. T. dhe E. T. ankoheshin se, rreth orës 01.00, duke qenë në një lokal Internet-Kafe, që ndodhej poshtë pallateve të tyre të banimit, ishin shoqëruar, padrejtësisht, nga patrulla e policisë në Komisarlatin e Policisë Nr. 4, Tiranë. Dy prej këtyre shtetasve ishin keqtrajtuar nga punonjësit e policisë dhe, për shkak të dëmtimeve të pësuar, ishin dërguar në spital nga policia për ekzaminim e mjekim dhe njëri prej tyre, që ishte më rëndë, ishte shtruar. Shtetasit ankues pretendonin edhe për kallëzim të rremë, të bërë ndaj tyre nga punonjësit e policisë, sikur kishin

kundërshtuar me dhunë, fyer e kërcënuar policët. Si pasojë e këtij kallëzimi të rremë, shtetasit B. K. dhe J. T. ishin arrestuar, ndërsa shtetasit M. K. dhe E. T. ndiqeshin penalisht në gjëndje të lirë.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese dhe nga provat e administruara, nga stafi i Avokatit të Popullit, u arrit në konkluzionin se, kishte indicie e dyshime të forta që pretendimet e ankuesve për keqtrajtim fizik, për shoqërim të paligjshëm në polici dhe për kallëzim të rremë ndaj tyre, ishin të bazuara.

Avokati i Popullit përgatiti një rekomandim, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të 4 punonjësve të policisë, efektivë të Komisarariatit të Policisë Nr. 4, Tiranë, për veprat penale të "Torturës", parashikuar nga neni 86 e 25 i K.Penal, të "Kryerjes së veprimeve arbitrare", parashikuar nga neni 250 e 25 i K.Penal dhe të "Kallëzimit të rremë", parashikuar nga neni 305 e 25 i K.Penal.

Në kohën e përfundimit dhe të dërgimit të këtij rekomandimi rezultoi se, mbi bazën e kallëzimit të ankuesve, organi i Prokurorisë kishte filluar ndjekjen penale për këtë çështje. Të ndodhur në këto kushte, kur për të njëjtin rast kishte një çështje penale të filluar nga organi kompetent, Avokati i Popullit vuri në dispozicion të ankuesve të gjitha provat e grumbulluara gjatë hetimit administrativ, me qëllim që ata t'i përdornin gjatë hetimit penal.

Në rastin e mësipërm konstatohet se, për shkak të dhunës së rëndë të ushtruar gjatë ndalimit, dy prej shtetasve janë shoqëruar për mjekim të specializuar në spital ku për njërin prej tyre është vendosur shtrimi. Nga ana tjetër, punonjësit e Policisë që kanë kryer shoqërimin kanë paraqitur kallëzim penal ndaj këtyre shtetasve për veprën penale "Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik", parashikuar nga neni 236, i Kodit Penal. Sipas ankuesve, kallëzimi ishte bërë nga punonjësit e policisë, për t'u mbrojtur nga ankimi që të afërmit e tyre kishin bërë për veprimet e tyre të kundërligjshme dhe për të justifikuar dhunën e ushtruar dhe pasojat ndaj të dëmtuarve.

Në Vendimin e GjEDNj Aksoy kundër Turqisë, të dt. 18 Dhjetor 1996, rezulton se, pavarësisht se shtetasi i keqtrajtuar nga policia ishte shtruar në spital, për shkak se ishin regjistruar dëmtime fizike, organi i Prokurorisë nuk kishte cilësuar të bazuar në ligj fillimin e ndjekjes penale. GjEDNj ka theksuar se, në rastet kur një individ mbahet në ndalim nga Policia dhe ka qenë në gjëndje të mirë shëndetësorei përket Shtetit barra e provës për të dhënë shpjegime të qarta për mënyrën e shaktimit të dëmtimeve, mosdhënia e të cilave përbën një rast të pastër të ngritur në kuadër të Nenit 3, të KEDNj.¹⁵

15 Tomasi kundër Francës, Vendim i dt. 27 Gusht 1992; Ribitsch kundër Austrisë, Vendim i dt. 04 Dhjetor 1995

Në rastin e mësipërm, në kushtet kur po shqyrtohej një kallëzim penal, organet shtetërore kishin detyrimin ligjor të verifikonin të gjithë rrethanat e ngjarjes dhe pas administrimit të provave (pyetja e dëshmitarëve okularë, e autorëve të dyshuar të ushtrimit të dhunës, e kqyrjes së dokumenteve në Komisarjatin e Policisë përgjegjës dhe në spital ku ishin ekzaminuar dhe mjekuar shtetasit, si dhe aktet e ekzaminimit mjeko-ligjor të dy të dëmtuarve), të fillonin ndjekjen penale ndaj punonjësve përgjegjës. Policia e Shtetit kishte për detyrë të provonte mungesën e lidhjes shkakësore midis veprimeve ose mosveprimeve të tyre dhe pasojave në shëndetin e shtetasve të keqtrajtuar.

3. Në datë 19.05.2011, në Bulevardin "Zogu i Parë" Tiranë, në afërsi të Ministrisë së Drejtësisë, disa shtetas janë ndaluar nga rreth 30 policë të Repartit RENE, të cilët kishin ushtruar dhunë ndaj tyre duke i goditur në kokë, në fytyrë dhe në pjesë të ndryshme të trupit. Për shkak të goditjeve të shumta dhe të forta, ata kanë humbur ndjenjat. Më pas ankuesit janë shoqëruar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Meqenëse gjendja e tyre shëndetësore ishte e rëndë, ata janë dërguar në Spitalin Ushtarak Tiranë për ekzaminim dhe ndihmë mjekësore. Për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, të dy të dëmtuarit ishin shtruar për të bërë ekzaminimet dhe mjekimet përkatëse. Duke qenë në spital, rreth orës 02.00 të datës 20.05.2011, ankuesit janë arrestuar në flagrancë për veprat penale të "Kundërshtimit me dhunë të punonjësit të policisë" dhe "Fyerjes për shkak të detyrës", parashikuar nga nenet 236/2 dhe 239, të K.Penal. Nga verifikimet e bëra dhe provat e administruara nga stafi i Avokatit të Popullit rezultoi se gjendja shëndetësore e ankuesve ishte e rënduar. Në trupin e tyre, si në kokë, në fytyrë e vende të tjera dukeshin shenja të qarta dhune, si plagë, hematoma, dërrmishje dhe ënjtje. Pasojat e dhunës u provuan edhe nga Aktet e Ekspertimit Mjeko-Ligjor, të bëra me kërkesën e Avokatit të Popullit; Ankuesit nuk kishin patur armë apo sende të tjera të ndaluara nga ligji, nuk kishin kundërshtuar me dhunë apo të kishin bërë ndonjë rezistencë ndaj punonjësve të policisë të Repartit RENE;

Avokati i Popullit konkludon se ankuesit ishin keqtrajtuar fizikisht dhe pa asnjë shkak nga punonjësit e policisë, duke iu shkaktuar vuajtje të rënda fizike deri në humbjen e ndjenjave dhe se ju ishte shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25, i Kushtetutës dhe neni 3, i Konventës Evropiane për të Drejtave e Njeriut.

Për shkeljet ligjore të përshkruara më sipër Avokati i Popullit bëri tre rekomandime ndër të cilët: një Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të policisë së shtetit, për veprën penale të "Torturës", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 86, e 25, të K.Penal, i ndryshuar.

Më tej në raportin e tij Avokati i Popullit shpjegon se meqenëse dy shtetasve të keqtrajtuar nuk u janë gjetur sende të paligjshme dhe ndalimi i tyre është bërë me prezencën një numri të madh të forcave të Repartit RENE A, përdorimi i forcës konsiderohet se ka tejkaluar nivelin minimum të ashpërsisë për ndalimin e tyre, po ta krahasojmë me praktikën e GJEDNJ dhe manualet përkatëse. Përdorimi i forcës dhe mjeteve në dispozicion nga Policia duhet bërë në mënyrën, kohën dhe intensitetin proporcional të arsyeshëm.

Edhe në këtë rast rezulton se ekzistojnë dokumente të qarta mjekësore, që tregojnë për ushtrimin e torturës, sepse, për shkak të gjëndjes së rëndë shëndetësore, dy shtetasit janë shoqëruar për trajtim në Spitalin Usharak Tiranë. Trajtimi jo-proporcional, me pasoja të rënda për shëndetin e këtyre shtetasve mund të jetë realizuar si ndëshkim për një veprim të kryer, ose që dyshohet të jetë kryer, ose për ndonjë qëllim tjetër që passjell poshtërimin apo trajtimin çnjerëzor (germat “b” dhe “d” të Nenit 86, të Kodit Penal).

4. *Avokati i Popullit, në datën 22 dhe 23 janar, në vijim të situatës se krijuar nga incidentet e ndodhura në demonstratën e organizuar në Tiranë në datën 21 janar 2011, kreu disa inspektime ne Komisarariatet e Policisë nr.1, 2, 3, 4 ne Tirane, ne Drejtorinë e Policisë se Qarkut Tirane si dhe ne Burgun nr. 313 dhe 302 .*

Nga inspektimet e kryera rezultoi se:

- a. *Në ditën e inspektimit në Drejtorinë e Policisë se Qarkut Tirane, ndodheshin te arrestuar 16 persona. Arrestimi i tyre ishte bërë për kryerje të veprave penale të parashikuara nga nenet 236, 237, 238 dhe 239 të Kodit Penal. Të arrestuarit pretendonin për ushtrim dhune fizike ndaj tyre, nga punonjësit e policisë, në momentin e shoqërimit në organet e policisë, si dhe gjatë pyetjes së tyre në këto organe. 2 prej tyre kishin shenja të dukshme të dëmtimit fizik në pjesë të ndryshme të trupit, të cilat u konstatuan nga ana e stafit të Avokatit të Popullit. U konstatua, gjithashtu, prania e mjekut të policisë duke bërë vizita e mjekime të arrestuarve të dëmtuar, por të 2 personat e dëmtuar, kërkonin t’u bëhej dhe ekspertim mjeko-ligjor, gjë e cila nuk rezultoi t’u ishte ofruar nga policia. - Të 16 personat e arrestuar pretendonin se ishin detyruar nga punonjësit e policisë, me dhune fizike e psikike, që të firmosnin procesverbalet e pyetjes dhe të arrestimit të tyre.*
- b. *Në Komisariatin Nr. 3, ndodheshin të ndaluar dhe arrestuar 19 persona, nga të cilët 4 të mitur. Nga intervistimi i të ndaluarve dhe arrestuarve u bënë prezent pretendimet si vijon: Të gjithë pretendonin se ndaj tyre ishte ushtruar dhunë fizike në momentin e ndalimit nga policia dhe gjatë shoqërimit të tyre për në Komisarariatet e Policisë së Shtetit. Të gjithë pretendonin se*

- ju ishin marrë deklaratime nga oficerë të Policisë Gjyqësore në kushte dhune psikologjike. Të gjithë pretendonin se megjithëse kishin firmosur, nuk kishin marrë dijeni për përmbajtjen e deklaratimeve të tyre dhe se ato kishin qenë veprime formale dhe të njëanshme të policisë. Megjithëse u konstatua rregullsia e pranisë procedurale të avokatit, gjatë pyetjes së të ndaluarve, provuar me nënshkrimet përkatëse në deklaratime, të gjithë pretendonin se gjatë marrjes së deklaratimeve nuk kishte qenë i pranishëm asnjë avokat dhe se nënshkrimet e tyre kishin qenë të mëvonshme. Megjithëse u konstatua nga stafi i Avokatit të Popullit rregullsia e pranisë procedurale të psikologut, provuar me nënshkrimet përkatëse në deklaratime, 4 të miturit pretendonin se krahas mungesës së avokatit gjatë marrjes së deklaratimeve nga policia gjyqësore nuk kishte qenë i pranishëm psikologu dhe nënshkrimi i tij ishte bërë me vonesë. Nga kqyrja e të ndaluarve dhe arrestuarve u konstatua se vetëm njeri prej tyre kishte një të çarë në kokë dhe për këtë i ishte dhënë ndihma mjekësore në spital. Të gjithë të ndaluarit dhe arrestuarit pranuan se gjatë qëndrimit në Komisaratin e Policisë Nr. 3, Tiranë nuk ishin keqtrajtuar.
- c. Në inspektimin e kryer në Paraburgimin 313 në Tiranë u konstatua se ndodheshin të ndaluar dhe arrestuar 41 persona, ndër të cilët 8 të mitur dhe 1 femër. Ndaj tyre ishin kryer veprimet procedurale dhe ata pritej të dilnin përpara gjykatës, për vleftësimin, ose caktimin e masës së sigurisë. Nga intervistimi i të ndaluarve dhe arrestuarve dhe pas kqyrjes së ambienteve ku ishin sistemuar u konstatua si vijon: Të gjithë pretendonin se ndaj tyre ishte ushtruar dhunë fizike në momentin e ndalimit nga policia dhe gjatë shoqërimit të tyre për në Komisaritet e Policisë së Shtetit. - Të gjithë pretendonin se ju ishin marrë deklaratime nga oficerë të Policisë Gjyqësore në kushte dhune psikologjike. Të gjithë pretendonin se, megjithëse kishin firmosur, nuk kishin marrë dijeni për përmbajtjen e deklaratimeve të tyre dhe se ato kishin qenë veprime formale të njëanshme të policisë. Të gjithë pretendonin se gjatë marrjes së deklaratimeve nuk kishte qenë i pranishëm avokati dhe nënshkrimet e tyre kishin qenë të mëvonshme. 8 të miturit pretendonin se krahas mungesës së avokatit, gjatë marrjes së deklaratimeve nga policia gjyqësore, nuk kishte qenë i pranishëm psikologu dhe nënshkrimi i tij mund të jetë bërë më vonë.
- ç. Në inspektimin e kryer në Paraburgimin 302 në Tiranë, u konstatua se ndodheshin të ndaluar dhe arrestuar 34 persona ndër të cilët 7 të mitur. Nga intervistimi i të ndaluarve dhe arrestuarve dhe pas këqyrjes së ambienteve ku ishin sistemuar u konstatua si vijon: -Të gjithë pretendonin se ndaj tyre ishte ushtruar dhunë fizike, në momentin e ndalimit nga policia dhe gjatë shoqërimit të tyre për në Komisaritet e Policisë së Shtetit. Të gjithë pretendonin se ju ishin marrë deklaratime nga oficerë të Policisë Gjyqësore në kushte dhune psikologjike. Të gjithë pretendonin se, megjithëse kishin firmosur, nuk kishin marrë dijeni për përmbajtjen e deklaratimeve të tyre dhe se ato kishin qenë veprime formale, të njëanshme, të policisë. Të gjithë

pretendonin se gjatë marrjes së deklaramëve nuk kishte qenë të pranishëm avokatët dhe nënshkrimet e tyre kishin qenë të mëvonshme.

Në Raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2011, lidhur me rastin e mësipërm zyra e Avokatit të Popullit konkludon se: *“Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë shqyrtimin dhe hetimin e rasteve kur punonjësit e policisë së shtetit, apo të burgjeve, kanë kryer veprime të dhunshme ndaj shtetasve, ose të dënuarve, me pasoja në shëndetin e tyre dhe më pas ka bërë rekomandim organeve të Prokurorisë për fillimin e hetimit për veprën penale të “Torturës”, mirëpo Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë ndryshuar kualifikimin e veprës në “Shpërdorim detyre” apo “Kryerje të veprimeve arbitrare”, dhe në përfundim është vendosur pushimi i çështjes penale”*

Siç ka konstatuar edhe Avokati i Popullit, rezulton se situatat e mësipërme tregojnë se jemi përpara rastit kur ndaj disa shtetasve, të përfshirë në një protestë, dyshohet se është ushtruar dhunë gjatë ndalimit të tyre nga policia dhe se deklaramet dhe pohimet dyshohej se ishin marrë në kushtet e presionit psikologjik dhe fizik. Gjithashtu dyshohet se ata janë detyruar të nënshkruajnë procesverbalin e arrestit në flagrancë, në shkelje të rëndë të garancive procedurale ligjore, për shkak të mospjesëmarrjes së psikologut dhe avokatit, të cilët dyshohet se kanë nënshkruar pa qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve hetimore. Të gjithë këta elementë mendojmë se janë të mjaftueshëm për të nisur hetimet me akuzë bazuar në nenin 86 të KP, por organet e akuzës kanë ushtruar ndjekje penale për veprat e *“Shpërdorim detyre”* apo *“Kryerje të veprimeve arbitrare”*, që siç trajtojmë më poshtë në këtë studim mendojmë se janë të papërshtatshme, juridikisht, për këto raste, po t’i referohemi praktikës së gjerë të GJEDNJ.

Nga ana tjetër edhe në Raportin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës¹⁶ thuhet se: *“Komisioneri sheh me shqetësim të madh problemet e hershme të keqtrajtitimit dhe pandëshkueshmërisë për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të kryera nga nga oficerët e zbatimit të ligjit, përfshirë edhe ato që lidhen me ngjarjet e dhunshme të 21 janarit 2011 në Tiranë. Autoritetet inkurajohen që të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që çdo pretendim për veprime të paligjshme, ku përfshihen edhe keqtrajtimet e kryera gjatë dhe pas ngjarjeve të 21 janarit, të hetohet në mënyrë të shpejtë dhe të efektshme dhe që personat përgjegjës të vihen përpara drejtësisë. Po kështu, është e nevojshme që të jepen ndëshkimet e duhura frenuese për të gjithë oficerët e zbatimit të ligjit të përfshirë në shkelje serioze të të drejtave të njeriut, sipas Udhëzimeve të Këshillit të Evropës.”*

Më tej Komisioneri shprehet në raportin e tij se sheh me shqetësim raportet që tregojnë se aksesit i të ndaluarve/arrestuarve, përfshirë edhe i atyre

¹⁶ Raporti i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, në vijim të vizitës në Shqipëri nga 23 deri 27 shtator 2013

minorenë, tek avokati apo mjeku është penguar ose mohuar. Komisioneri u bën thirrje autoriteteve që të vënë në zbatim të gjitha rekomandimet përkatëse të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor apo Poshtëruës (CPT) dhe i nxit ato që të sigurojnë që psikologët të jenë gjithmonë të pranishëm gjatë procedimeve penale ku përfshihen minorenë.

2.2 Rreth qëndrimit të mbajtur nga zyra e Avokatit të Popullit rreth rasteve të torturës dhe trajtimit çnjerëzor, degradues.

Në Raportet vjetore të Avokatit të Popullit për v. 2010-2011 trajtohen dhe çështje, që janë ndjekur nga ky institucion, për të cilat është kryer hetim administrativ, bazuar në ankesat dhe verifikimet që ai kishte ushtruar. Pranë këtij institucioni funksionon Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Torturës si strukturë e specializuar e cila ka për detyrë të monitorojë, pranë të gjitha mjediseve ku është kufizuar liria e individit, për të verifikuar mbrojtjen që garantohet nga tortura e trajtimi çnjerëzor, degradues i shtetasve të sistemuar pranë tyre. Në vitet 2012-2014, Avokati i Popullit ka paraqitur në prokurori rekomandime për fillimin e ndjekjes penale për krimin e torturës (në v. 2014 – 2 rekomandime për Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Tiranë; në v. 2013. – 2 rekomandime për Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Tiranë; në v. 2012 – 5 rekomandime për prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Durrës, Tiranë).¹⁷

Rastet e shkeljes së ligjit në ngjarjet e 21 Janarit 2011, përmenden në mënyrë të detajuar në Raportin e Avokatit të Popullit. Siç pëshkruhet kjo dhunë rezulton se ka dyshime dhe indicie të forta se veprimet e punonjësve të policisë kanë qënë jo vetëm arbitrare, por dhe me elementë të trajtimit çnjerëzor, degradues (*dhuna fizike në momentin e ndalimit nga policia, në publik në sy të kalimtarëve të tjerë dhe gjatë shoqërimit të tyre për në Komisaritet e Policisë; marrja e deklarimeve dhe nënshkrimi i tyre nga Oficerët e Policisë Gjyqësore në kushte dhune dhe presioni psikologjik; mungesa e avokatëve, psikologëve; mungesa e njoftimit të familjarëve për vendndodhjen e pjesëtarëve të familjes etj*). Veç të tjerash, në Raport thuhet se: *“...jo vetëm nga të intervistuarit prej nesh të cilët ndodheshin në ambientet e institucioneve të specializuara (në komisaritet e policive ose në vendet e paraburgimit që përshkruhen në raport), por edhe nëpërmjet medias elektronike pamë raste ku policia ushtronte dhunë pas përfundimit të demonstratës dhe largimit të protestuesve”*.

Në përfundim të raportit të vet, Avokati i Popullit sqaron se:

- *I rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe për dieni*

¹⁷ Raportet e Posacme te Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për v. 2012, 2013 dhe 2014

Ministrit të Brëndshëm, të instruktohen të gjithë efektivët e policisë për të mos ushtruar dhunë në situatë të panevojshme.

- *Të respektohen me korrektësi të gjitha garancitë procedurale të parashikuara në K.Pr.P dhe akteve të tjera ligjore ndaj të shoqëruarve, ndaluarve dhe të arrestuarve, etj.*

Kemi mendimin se rekomandimet e mësipërme janë të nevojshme, por të pamjaftueshën dhe jo në përputhje me situatën e konstatuar. Dihet publikisht se rastet e mësipërme, të dyshuara për torturë, ose trajtim çnjerëzor, degradues, që parashtron raporti i Avokatit të Popullit nuk u proceduan dhe as u gjyquan kurrë. Lidhur me këtë situatë kanë mbajtur qëndrim dhe organizmat ndërkombëtare. Gjithashtu dhe 2 çështje të denoncuara nga Avokati i Popullit për veprën penale të Torturës (n. 86 KP) dhe të pushuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezultojnë të jenë kundërshtuar në gjykatën përkatëse.

Vlerësojmë se, institucione publike siç është Avokati i Popullit, kur konstatojnë kryerjen e një vepre penale (torturë) nuk duhet që të kufizohen vetëm me "Rekomandimin" që paraqesin në Prokurori por duhet që çështjen e rekomanduar ta ndjekin edhe më tej pasi Prokuroria të ketë vendosur mosfillimin e procedimit, pushimin e procedimit apo dërgimin për gjykim. Nëse çështja e rekomanduar (*që në fakt duhet të konsiderohet kallëzim penal ose denoncim*) nuk fillon ose pushon, ky institucion, si çdo subjekt tjetër, duhet t'i drejtohet me ankim Gjykatës.

Në Ligjin nr. 8454, dt. 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kur bëhet fjalë për kompetencat, përcaktohet se ky institucion **i rekomandon** Prokurorisë të fillojë hetime nëse vëren se është konsumuar figura e një vepre penale. Kjo kompetencë nuk përputhet me sa përcakton neni 281/1, i Kodit të Procedurës Penale ku thuhet se: "*Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht, **detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim** edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepër penale".*

Jemi të mendimit se kjo kontradiktë midis dy dispozitave ligjore, që janë miratuar me të njëjtën shumicë të cilësuar në Kuvend, duhet të zgjidhur në favor të Kodit të Procedurës Penale i cili është dispozita specifike lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale. Punonjësit e Avokatit të Popullit janë nëpunës publikë dhe nuk mund t'i shmangen detyrimit që përcakton neni 281/1 KPrP sepse vetëm duke marrë rolin e kallëzuesit mund të legjitimohet të ndjekë ecurinë e çështjes në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë dhe të mbrojtë, në mënyrë substanciale, të drejtat e shtetasve, siç përcaktohet në misionin e këtij institucioni.

2.3 Të dhëna rreth rasteve të trajtuara pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë dhe analiza e tyre

KShH ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Elbasan mbi veprat penale të parashikuara në nenet 86, 87, 248, 250, dhe 314, të Kodit Penal, për vitet 2011-2012.

Nga informacioni që u dërgua nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për v. 2011, rezultuan këto të dhëna:

Neni 86	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	1	1			
Nr. i procedimeve të regjistruara					

Neni 248	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	238	131			
Nr. i procedimeve të regjistruara	107		10	47	1

Neni 250	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	11	4			
Nr. i procedimeve të regjistruara	7		3	3	

Për vitin 2012 rezultuan këto të dhëna:

Neni 250	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	1				
Nr. i procedimeve të regjistruara	1			1	

Neni 250	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	300	162			
Nr. i procedimeve të regjistruara	138		8	58	5

Neni 250	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	21	6			
Nr. i procedimeve të regjistruara	15		2	9	3

Për v. 2011, me akuzë **nenin 86, të Kodit Penal, rezulton i regjistruar 1 kallëzim për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal**; për nenin 248 KP, rezultojnë 238 kallëzime penale të regjistruara, nga të cilat janë regjistruar si procedime penale 107 prej tyre dhe nga këto procedime penale të regjistruara, vetëm 10 janë dërguar për gjykim, ndërsa 47 janë pushuar dhe 1 është pezulluar. **Midis çështjeve të dërguara për gjykim me këtë akuzë nuk pati asnjë rast që të lidhej me ushtrimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj shtetasve, që mund të kishte elementë të torturës ose trajtimit çnjerëzor, degradues**; për veprën penale të parashikuar nga neni 250 KP, rezultojnë të regjistruara 11 kallëzime penale, nga të cilat 7 janë regjistruar për procedim penal dhe prej tyre, 3 janë dërguar për gjykim ndërsa 3 janë pushuar, për një çështje nuk ka informacion. Në këtë informacion nuk pati të dhëna në lidhje me ushtrimin e dhunës fizike apo psikologjike nga punonjës të policisë së shtetit apo burgjeve ndaj shtetasve me liri të kufizuar, që mund të kishte elementë të torturës, trajtimit çnjerëzor apo degradues. **Për nenet 87 KP dhe 314 KP, për v. 2011, nuk ka patur të regjistruar asnjë kallëzim penal.**

Gjatë këtij viti, nëpërmjet Klinikës Ligjore, KShH ka trajtuar 53 ankesa të ardhura nga institucionet penitenciare dhe 1 ankesë nga komisarati i policisë, që ndodhen në Tiranë. Në kushtet kur rreth 34% të ankesave nga shtetas me liri të kufizuar kanë objekt dhunën fizike apo psikologjike të stafit policor në burgje dhe komisarate, kushtet e rënda në këto ambjente, mbipopullimin e ndjeshëm, mungesën e shërbimit shëndetësor, etj., rezultojnë rreth 18 prej shtetasve gjatë vitit 2011 kanë pretenduar shklje të nenit 3 të KEDNj-së, pra shqetësim për prezencën e kushteve të torturës, trajtimit çnjerëzor apo poshtëruës. Këto rrethana nuk janë reflektuar në kallëzime, procedime penale apo vendime gjyqësore në praktikën e organeve përkatëse në Tiranë. Për v. 2012, për **nenin 86, të Kodit Penal rezulton i regjistruar 1 kallëzim penal, i regjistruar si procedim penal për të cilin rezulton se më pas është vendosur pushimi i ndjekjes penale**; për nenin 248 KP, rezultojnë 300

kallëzime penale të regjistruara, nga të cilat janë regjistruar si procedime penale 138 prej tyre dhe nga këto vetëm 8 janë dërguar për gjykim, 58 janë pushuar dhe 5 janë pezulluar. **Midis çështjeve të dërguara për gjykim me këtë akuzë nuk pati asnjë rast që të lidhej me ushtrimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj shtetasve, që mund të kishte elementë të torturës ose trajtimit çnjerzor, degradues.**

Për veprën penale të parashikuar nga neni 250 KP, rezultojnë të regjistruara 21 kallëzime penale, nga të cilat 15 janë regjistruar për procedim penal dhe nga këto 15 procedime penale, 2 janë dërguar për gjykim, 9 janë pushuar dhe 3 janë pezulluar. Në këtë informacion nuk pati të dhëna në lidhje me ushtrimin e dhunës fizike apo psikologjike nga punonjës të policisë së shtetit apo burgjeve ndaj shtetasve me liri të kufizuar, që mund të kishte elementë të torturës, trajtimit çnjerzor apo degradues. **Për nenet 87 dhe 314, të Kodit Penal, për v. 2012, nuk ka patur të regjistruar asnjë kallëzim penal.**

Në këtë periudhë, KShH ka vazhduar të trajtojë 26 ankesa të ardhura nga institucionet penitenciare dhe komisariatet e policisë, që ndodhen në Tiranë. Bazuar në faktin se 22% të ankesave nga të dënuar/paraburgosur apo arrestuar/ndaluar lidhen me cënimin e nenit 3 të KEDNj-së, rezultojnë rreth 6 ankesa nga institucionet në kompetencën territoriale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pavarësisht numrit voluminoz të kallëzimeve dhe procedimeve në këtë organ gjatë një viti, nga të dhënat e mësipërme rezultonte vetëm 1 kallëzim dhe procedim penal për shkelje të nenit 86 të Kodit penal, duke mos reflektuar në atë masë shqetësimin për rrethanat e konsumimit të veprës penale të torturës, të paraqitur pranë KShH-së.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk na krijoi mundësinë të njiheshim me të gjitha materialet e çështjeve të mësipërme. Ky institucion na dërgoi zyrtarisht 2 vendime, përkatësisht vendimin e mosfillimit të procedimit penal të v. 2011 dhe vendimin e pushimit të procedimit penal të v. 2012, për veprën penale të parashikuar nga neni 86, të Kodit Penal.

Kallëzimet penale për këto dy vendime të Prokurorisë ishin paraqitur nga Avokati i Popullit, respektivisht, në v. 2011 dhe në v. 2012, respektivisht me Nr.3329 dhe Nr.2767, i cili rezulton se është vënë në lëvizje pas ankesave të të dëmtuarve dhe të afërmeve të tyre. Ngjarjet lidhen me pretendimet për dhunë gjatë një shoqërimi të një shtetasi nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe pretendime për ushtrim dhune fizike ndaj dy shtetasve të paraburgosur në IEVP "Jordan Misja" nga punonjës të Policisë së Burgjeve. Ballafaquar me standartet e rezultuara nga praktika e GjEDNj-së në lidhje me karakteristikat e hetimit penal¹⁸ në rastet e pretenduara të torturës, trajtimit çnjerzor apo degradues, mund të konkludohet se:

a) Hetimi nga Prokuroria ka zgjatur rreth 2 muaj që prej marrjes së materialit kallëzues të Avokatit të Popullit dhe rreth 3 muaj nga ngjarja për çështjen e vitit 2011, si dhe 22 ditë që prej marrjes së materialit kallëzues nga Avokati i Popullit dhe rreth 2 muaj nga ngjarja, për rastin e vitit 2012. Këto afate janë relativisht të gjata në rastin e parë, duke marrë në konsideratë faktin se janë administruar vetëm dy akte ekspertimi mjeko-ligjore të realizuara para nisjes së hetimit nga Prokuroria dhe dëshmitë e punonjësve të policisë që ishin në vendngjarje. Nërsa, koha prej 22 ditësh të hetimit për rastin e dytë është relativisht e shkurtër, duke patur në konsideratë faktin se janë administruar 11 deklaramë nga personat e kallëzuar të përfshirë në ngjarje dhe kallëzuesit, shtetas të dënuar, si dhe janë kqyrur në cilësinë e provës shkresore disa regjistra me të dhënat e ngjarjes të mbajtur nga institucioni penitenciar, duke përfshirë aktin e ekspertimit mjeko-ligjor.

Zgjatja e afatit kohor të hetimit pa administruar prova të shumta hetimore apo kryerja e shumë veprimeve hetimore për një kohë shumë të shkurtër nuk janë në përputhje me standartet e GjEDNj-së në lidhje me proporcionalitetin e kohëzgjatjes së procesit në varësi me kompleksitetin e rrethanave të çështjes, pavarësisht respektimit formal të afatit të hetimit parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

b) Në të dyja vendimet e studiuara të Prokurorisë, rezultonte se janë administruar vetëm dëshmitë apo deklaramet e personave të përfshirë në ngjarje (punonjësit e policisë së rendit dhe punonjësve të burgut) dhe të të dëmtuarve, por mungojnë dëshmitë e mundshme të shtetasve të tjerë, me liri të kufizuar që mund të kishin dijeni për rrethanat apo të sekuestroreshin materialet filmike të institucionit për momentin e pretendimit të dhunës.

Në çështjen e vitit 2011, ekspertimi mjeko-ligjor për të dëmtuarin është kryer 6 ditë pas ngjarjes duke ulur mundësinë e gjetjet së "gjurmëve" pavarësisht se u arrit të zbuloheshin *ekimoza dhe enjtje të kyçit*, ndërsa për punonjësit e policisë së rendit që ishin kallëzuar, ekspertimi mjeko-ligjor ishte realizuar vetëm 3 ditë pas ngjarjes. Ndërsa, në çështjen e vitit 2012, janë administruar Raporti mjekësor plotësuar nga mjeku u institucionit një ditë pas ngjarjes dhe akt ekspertimi mjeko-ligjor realizuar dy ditë pas ngjarjes, në kontradiktë me njëra tjetrën. Në Raport shkruhej se i paraburgosuri *nuk kishte asnjë problem shëndetësor* ndërsa në aktin e ekspertimit *konstatohej ekimoza të shkaktuara me mjete të forta mbrejtëse*.

Nga studimi i këtyre vendimeve të Prokurorisë nuk rezultoi të ishte kryer një ekspertizë e re mjeko-ligjore për të përcaktuar një regjistrim të saktë dhe të plotë të gjendjes shëndetësore, në kushtet e akteve të mëparshme mjeko-ligjore në kontradiktë me njëra- tjetrën. Nevoja e kryerjes së veprimeve të tilla hetimore rezulton nga detyrimi pozitiv që ka çdo shtet që aderon në konventat ndërmbëtare të lartpërmendura, në mbrojtjen e individit nga

tortura, trajtimi çnjerëzor apo degradues, prej cilido anëtar të shoqërisë, veçanërisht punonjësve shtetëror, nëpërmjet hetimit të plotë dhe të efektshëm.

c) Sa i përket detyrimit të shtetit, rezultuar nga praktika e GjEDNj-së, për një qasje të arsyeshme për hetimin e pretendimeve të viktimës apo të afërmve, kjo nuk mund të pohohet me siguri në çështjen e vitit 2011, pasi nuk është marrë në konsideratë deklarimi i "kushëririt" të viktimës në lidhje me dhunën e ushtruar nga punonjësit e policisë, në kushtet kur janë administruar vetëm dëshmitë e punonjësve të policisë së përfshirë në atë ngjarje. Deklarimet e tij janë cilësuar si "*objektivisht të njëanshme*" dhe arsyetimi i vendimit të pushimit të Prokurorisë konsiston në lidhjen e "*logjikshme*" të ekimozave në ato pjesë të trupit ku kapen personat për shoqërimin nga punonjësit e policisë, në ushtrim të detyrës së tyre. Në vendim nuk konstatohet marrja e dëshmisë së ndonjë personi që mund të ketë në vendngjarje, pavarësisht se ka ndodhur në oborrin e shtëpisë së tij nga dy patrulla policie, për shkak të rezistencës të të dëmtuarit.

Gjithashtu, në vendimin e pushimit të Prokurorisë për çështjen e vitit 2012 nuk konstatohet të jenë administruar dëshmi të shtetasve të tjerë me liri të kufizuar, të cilët mund të kenë qenë të pranishëm gjatë konfrontimit të të dëmtuarve me punonjësit e policisë së burgut. Sekuestrimi i materialeve filmike të mundshme si dhe hetimi i kontradiktës së Raportit mjekësor dhe aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, apo thënieve të njërit prej të dëmtuarve, në rrethanat kur janë administruar vetëm dëshmitë e punonjësve shtetëror në institucion dhe dokumentacionit të plotësuar prej tyre, mund të përbënin veprime hetimore më të thelluara në respekt të standartit të përforcuar nga praktika e gjatë e GjEDNj-së, për kryerjen e një hetimi të plotë dhe të besueshëm për palët e përfshira. Në vendimet e Prokurorisë thuhet se ndjekja penale ka filluar në bazë të materialit kallëzues apo rekomandimit të ardhur nga Avokati i Popullit, në të dy këto vendime citohet: "*Të njoftojë me këtë vendim të interesuarit të cilët kanë të drejtën e ankimit sipas ligjit*" dhe "*Të njoftojë më këtë vendim të interesuarit të cilët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose tek prokurori më i lartë*".

Mirëpo, në bazë të nenit 291, paragrafi 2, të K.Pr. Penale: "*Vendimi (i mosfillimit të procedimit penal) u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit.*" Ndërsa, sipas nenit 329, pika 1, të KPr.Penale: "*Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri*". Cilët janë të "interesuar" në rastin konkret nuk del e qartë, sepse në vendimet e Prokurorëve nuk përmendet as Avokati i Popullit dhe as personat që kanë pretenduar se ndaj tyre apo të afërmve të tyre është ushtruar dhunë.

Nga shqyrtimi i dosjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk rezultoi që këto dy vendime të Prokurorisë të ishin kundërshtuar. KSHH nuk ka informacion në lidhje me marrjen e njoftimit të Avokatit të Popullit për këto vendime. Edhe në Raportet e Avokatit të Popullit nuk flitet për kundërshtimim në gjykatë, ndaj vendimeve të refuzimit ose pushimit të ndjekjes penale, nga ana e prokurorëve, për rastet e “kallëzuara” apo “rekomanduara” Nga Avokati i Popullit, bazuar në nenin 86, të Kodit Penal.

- **Nga studimi i dokumentacionit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitin 2011**

Nga shqyrtimi i akteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë na rezultoi se, përgjithësisht, gjatë hetimit dhe gjykimit, ngjarjet ku rezultonte të ishte ushtruar dhunë fizike ndaj shtetasve, prej organeve të rendit, të hetimit, ose nga punonjësit e burgjeve e paraburgimeve, ishin kualifikuar sipas nenit 250 KP, “Kryerja e veprimeve arbitrare”. Dy çështjet e tjera ishin ankimuar në instancat më të larta gjyqësore dhe shqyrtimi i tyre ende nuk kishte përfunduar.

Nga studimi i këtyre dosjeve konstatuam se:

- 1) Gjykata dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kuptuar dhe zbatuar drejtë dispozitat 90 “Dëmtime të tjera me dashje” dhe 248 “Shpërdorim i detyrës” të Kodit Penal, pasi asnjë nga çështjet e trajtuara në këto vendime nuk kishte elementë objektivë dhe subjektivë të figurës së veprës penale të Torturës, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal.

Në vendimet mbi nenin 90 të Kodit Penal, subjekti aktiv dhe pasiv ishin të përgjithshëm dhe dhuna nuk tejkalonte ashpërsinë minimale që kërkon konsumimi i veprës penale të Torturës. Gjendja shëndetësore dhe efektet fizike apo mendore të të dëmtuarit ishin vlerësuar deri në 9 ditë paaftësi të përkohshme në punë, pasi rezultonin tepër të lehta. Shumica e çështjeve ishin pushuar për shkak të mungesës së paraqitjes të të dëmtuarit-akuzues.

Ndërsa në çështjet mbi nenin 248 të Kodit Penal, rrethanat e faktit nuk kishin të bënin me ushtrim dhune që të kishin shkaktuar gjendje shëndetësore apo efekte të rënda në shëndetin mendor dhe fizik të të dëmtuarve, por me shpërdorimin e tagrave të shtetasve zyrtarë, duke dëmtuar interesa ekonomike të shtetasve të tjerë.

- 2) Në çështjet mbi nenin 250 të Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare”, Prokuroria dhe gjykata nuk kanë bërë hetim të plotë dhe

të gjithanshëm, pasi shumica e dëshmitarëve të pyetur, si ata që kanë qënë të pranishëm në momentin e ushtrimit të dhunës edhe ata që nuk kishin qënë të pranishëm (shumica punonjës të policisë) **ishin të njëanshëm dhe të rezervuar për të dhënë sqarime të qarta dhe të plota mbi rrethanat e ngjarjes.** Dëshmitë apo deklaratimet e punonjësve shtetërorë të përfshirë në ngjarje apo kolegët e tyre, përbëjnë provat me dendurinë më të madhe të administruara në gjykim, ndërsa deklaratimet e dëshmitarëve të tjerë të papërfshirë në ngjarje mungonin pothuajse në të gjitha çështjet e studiuara;

- 3) Dhuna e ushtruar ka shkaktuar **poshtërimin e dinjitetit të shtetasve të dhunuar si dhe lëndim fizik të tyre duke tejkaluar nivelin minimal të ashpërsisë, në kuptim të parimit të proporcionalitetit.** Në disa raste, veprimet aktive të dhunës janë kryer në ambiente publike apo në prani të familjarëve dhe personave të tjerë, me *shkop gome dhe grushte e shkelma* nga disa punonjës shtetërorë njëherësh, pra në bashkëpunim. Shtetasit e dëmtuar kanë pësuar ekimoza apo edema të madhësive të ndryshme, deri mbi 10 cm gjatësi, në pjesë të ndryshme të trupit, duke përfshirë zonën e kokës e të fytyrës, si dhe në disa raste ka shkaktuar probleme në lëvizje edhe pse i dëmtuari ka qënë në moshë relativisht të re. Në përgjithësi, shenjat kanë qënë të dukshme deri pas 10 -ditësh, kohë në të cilën janë kryer aktet e ekspertimit mjeko-ligjor;
- 4) Në **vizitat e kryera nga mjeku ose në lëshimin e raporteve mjekësore, vërehen vonesa, që shkonin nga 4-10 ditë nga ngjarja,** fakt që zbeh dhe pengon përcaktimet e sakta të dëmtimeve dhe të gjëndjes shëndetësore të të dëmtuarve;
- 5) Disa të pandehur e pranonin akuzën, me synimin për të zbutur përgjegjësinë, ose për qëllim lehtësimin e pozitës së tyre, duke konfunduar me kërkesën për gjykim të shkurtuar. Ata justifikoheshin me “faktin” se qëndrimi, sjellja e të dëmtuarve, nuk kishin qënë të drejta, ose kishte qënë provokuese duke mos iu bindur urdhërit të ligjshëm të tyre, por në fakt, në shumicën e çështjeve, kjo nuk vërtetohej nga provat e shqyrtuara gjatë gjykimit;
- 6) Proçesi hetimor ka rezultuar më i shkurtër në kohë se proçesi gjyqësor, pavarësisht faktit se në gjykim janë administruar në cilësinë e provës, vetëm rrethanat dhe faktet, pjesë e dosjes së prokurorisë. Kohëzgjatja mesatare e proçesit hetimor është konstatuar 5-6 muaj, ndërsa kohëzgjatja e proçesit gjyqësor ka rezultuar mesatarisht 7-8 muaj, duke mos-reflektuar kompleksitetin e çështjes, të rrethanave dhe faktit, apo provave të administruara.

- 7) Hetimi dhe gjykimi i pretendimeve të të dëmtuarve apo të afërmëve të tyre ka ardhur si pasojë e materialit kallëzues nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, i cili është vënë në lëvizje nga të dëmtuarit dhe në disa raste nga Avokati i Popullit, e në asnjë rast të filluar kryesisht nga Prokuroria. Në raport me faktet e hetuara dhe administruara në cilësinë e provës në gjykim, si dhe dënimin e të pandehurve, nuk rezulton një qasje e plotë dhe e arsyeshme ndaj pretendimeve të të pandehurve, në proces. Administrimi i procesit nëpërmjet deklarimeve të punonjësve shtetërorë të akuzuar për kryerjen e krimit, dëshmime të kolegëve të tyre, dokumentacionit të mbajtur nga institucioni ku punojnë, si dhe theksimi i rrethanave lehtësuese të të pandehurve, duke konkluduar me dënime me gjobë apo dënime alternative, pa marrë dëshmi apo deklarime të dëshmitarëve të papërfshirë në ngjarje apo kryerjen e ekspertimeve të tjera mjeko-ligjore, nuk pasqyrojnë me siguri, një hetim dhe gjykim të gjithanshëm e të arsyeshëm;
- 8) U vërejt një lloj unifikimi i qëndrimit të Prokurorisë dhe Gjykatës **sidomos në caktimin e masave të dënimit të cilat ishin tepër të buta, gjë që tregon qasje të njëjtë të këtyre organeve lidhur me rrezikshmërinë e këtyre veprave penale.**
- 9) Rezultojnë masat **tepër të lehta dënimi të kërkuara nga prokurori dhe të caktuara nga gjykata, përgjithësisht nën minimumin e parashikuar nga ligji.** Në vendimet e gjykatës evidentohet rrezikshmëria e veprës penale (në çdo rast dhuna ishte ushtruar nga punonjës të Policisë, gjatë kufizimit të lirisë së shtetasve), por ndërsa masa e dënimit e parashikuar nga ligji shkon deri në 7 vjet burgim, gjykatat vazhdimisht arsyetonin në funksion të lehtësimit të përgjegjësisë penale të të pandehurit. Konkretisht në vendimet gjyqësore të shqyrtuara gjykatat kanë dhënë një nga vendimet si vijon:
- I/të pandehuri/t deklaroheshin fajtor/ë për veprën penale, të parashikuar nga neni 250 KP dhe i jepej dënimi me gjobë, e cila varionte, sipas rrethanave, nga 80 000 lekë - 150 000 lekë, si dhe caktohej afat për shlyerjen e gjobës;
 - Gjykata pranonte kërkesën për gjykim të shkurtuar, sipas nenit 406, të Kodit të Proçedurës Penale; I/të pandehuri/t deklaroheshin fajtor/ë për veprën penale, të parashikuar nga neni 250 KP dhe u jepej dënimi me gjobë, duke ulur 1/3 e dënimit, si dhe caktohej afati për shlyerjen e gjobës;
 - Gjykata pranonte kërkesën për gjykim të shkurtuar, sipas nenit 406, të Kodit të Proçedurës Penale, I/të pandehuri/t deklaroheshin fajtor/ë, sipas nenit 250 KP, dënoheshin me burg, i cili varionte

nga1 deri 4 muaj burgim; ulej 1/3 e dënimit me burgim, për shkak të gjykimit të shkurtuar; vendosej pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim sipas nenit 63, të Kodit Penal dhe dënimi zëvendësohej me punë (orë pune) në interes publik;

- I/të pandehuri/t deklaroheshin fajtor/ë për veprën penale, të parashikuar nga neni 250 KP dhe jepej dënim me burgim; urdhërohej pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe autori vihej në në provë, sipas nenit 59, të Kodit Penal;

2.4 Të dhëna rreth rasteve të trajtuara pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan dhe analiza e tyre

Edhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan u kërkuar i njëjti informacion për vitet 2011-2012. **Ky institucion, ndryshe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, na mundësoi studimin e dosjeve hetimore dhe ofroi informacion si vijon:**

Nga statistikat e dërguara nga kjo prokurori për vitin 2011 rezultojnë këto të dhëna:

Neni 248	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	36				
Nr. i procedimeve të regjistruara ²⁰	36		4	19	1

Neni 250	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	4				
Nr. i procedimeve të regjistruara	4			4	

Për nenet 86, 87 dhe 314, të Kodit Penal, për vitin 2011, nuk ka patur të regjistruar asnjë kallëzim penal. Pavarësisht këtyre të dhënave, gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet Klinikës Ligjore, KShH ka trajtuar 24 ankesa të ardhura nga I EVP Peqin, ndër të cilat rreth 34% e tyre (pra rreth 9-10 ankesa) kanë pasur për objekt dhunën e ushtruar në burg nga personeli, mosdhënien e shërbimit shëndetësor në raste nevojë, mbipopullimin, kushtet e këqija në

19 Në të gjitha rastet e verifikuara, vepra penale nuk përmbante elementë të ushtrimit të dhunës

burg/paraburgim, etj., të cilat potencialisht përbëjnë rrethana për shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, praktikës së GjEDNJ-së dhe nenit 86 të Kodit Penal. Por, nga informacionet e dhëna të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka kompetencë territoriale për këtë institucion, nuk rezulton asnjë kallëzim dhe procedim për kryerjen e kësaj vepre penale, duke mos reflektuar masën e shqetësimeve të karakterit të tillë në një ndër institucionet më të rëndësishme penitenciare në vend.

Ndërsa, për vitin 2012, të dhënat që vijojnë:

Neni 248	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	35	7			
Nr. i procedimeve të regjistruara ²⁰	28		4	17	

Neni 250	Total	Mosfilluar	Dërguar për gjykim	Pushuar	Pezulluar
Nr. i kallëzimeve të regjistruara	2				
Nr. i procedimeve të regjistruara	2			2	

Për nenet 86, 87 dhe 314, të Kodit Penal edhe për vitin 2012, nuk ka patur të regjistruar asnjë kallëzim penal. Për vitin 2012 KShH ka vazhduar trajtimin e 14 ankesave nga IEVP Peqin, në kushtet kur rreth 22% të ankesave ardhur nga shtetasit me liri të kufizuar kanë pasur objekt dhunën e ushtruar në burg nga personeli, mosdhënien e shërbimit shëndetësor në raste nevojë, mbipopullimin, kushtet e këqija në burg/paraburgim, etj., të cilat potencialisht përbëjnë rrethana për shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, praktikës së GjEDNJ-së dhe nenit 86 të Kodit Penal.

Në të gjitha çështjet e regjistruara me akuzë sipas nenit 248 KP nuk kishte prani të dhunës fizike ose psikologjike dhe as elementë të tjerë që mund të ndikonin për kualifikimin e veprës si torturë, ose trajtim çnjerëzor, degradues.

Nga aktet e 6 dosjeve hetimore që na u vunë në dispozicion nga Prokuroria Elbasan, rezultoi se organi i akuzës ka konkluduar si vijon:

²⁰ Në të gjitha rastet e verifikuara, vepra penale nuk përmbante elementë të ushtrimit të dhunës

- 1) Çështja me nr. 1716, dt. 12.12.2012 (pa autor), për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, në bashkëpunim, sipas neneve 250 e 25 të Kodit Penal është pushuar në dt. 06.05.2013. Kallëzuesi S.V. (shtetas që vuante dënimin në burgun Peqini) kishte kallëzuar tre punonjës të policisë së burgut sepse kishin ushtruar dhunë. Si punonjësit e policisë, edhe të dënuarit e tjerë kanë mohuar keqtrajtimin e kallëzuesit dhe objekti i konfliktit u pretendua të kishte lidhje me funksionimin e dushit, jo siç pretendonte kallëzuesi.

Në këtë çështje është deleguar Oficeri i Policisë Gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore nga prokurori përkatës. Nga dokumentacioni në dosjen hetimore ka rezultuar se OPGj ka marrë në pyetje **3 muaj pasi ka nisur hetimi**, punonjësit e burgut të kallëzuar dhe kolegë të tyre, në cilësinë e personit që ka dijeni për ngjarjen. Kamerat e institucionit nuk rezultuan të ishin sekuestruar, pavarësisht se ishte deleguar si veprim hetimor nga prokurori i çështjes dhe ishte e detyrueshme për zbatim. Hetimi ka nisur menjëherë pas kallëzimit (rreth 1 muaj nga ngjarja) dhe ka zgjatur 5 muaj, duke rezultuar në një kohëzgjatje të paarsyeshme në raport me provat e administruara në dosje.

Gjatë hetimit nuk ka pasur një qasje plotësisht të arsyeshme ndaj kallëzimit të të dënuarit kallëzues pasi nuk janë pyetur dëshmitarë të tjerë në institucion, si dhe nuk janë sekuestruar pamjet filmike që do të mund të verifikonin me siguri ngjarjen e pretenduar. Roli aktiv i organit të hetimit është e nevojshme për të qenë në përputhje me standartet e GJEDNj-së lidhur me “qasjen e arsyeshme” ndaj kallëzimit të të dënuarit.

Pavarësisht faktit se është administruar një akt ekspertimi mjekoligjor që mohon vizitën në spitalin e institucionit të të dënuarit kallëzues dhe konfirmon vetëm marrjen e një paracetamoli, pa përcaktuar dëmtime fizike apo jo, të qenurit me liri të kufizuar në kushtet e një institucioni të mbyllur është një rrethanë që duhet marrë në konsideratë për kryerjen e veprimeve hetimore të tilla që nuk lënë dyshime për pafajësinë ose jo të punonjësve shtetërorë, në rastet e pretendimeve për ushtrim dhune.

- 2) Shtetasi R.M. kishte kallëzuar se ishte keqtrajtuar nga punonjës të Policisë në Cërrik duke i shkaktuar disa gërvishtje në fytyrë. Me gjithë pretendimet e kallëzuesit se është ndaluar nga punonjësit e policisë kur ai ishte duke udhëtuar me makinë, dëshmitarët e tjerë të pyetur në këtë çështje megjithëse e pranuan si fakt, mohuan keqtrajtimin. Në

Raportin e Mjekut nuk rezultonte që i dëmtuari të kishte paaftësi të përkohshme në punë. Prokuroria kishte bërë bashkim çështjes pasi paraprakisht punonjësi i policisë kishte kallëzuar penalisht shtetasin për "Fyerje për shkak të detyrës", ndërsa shtetasi për keqtrajtim. Në fund rezultoi se vetë punonjësi i policisë ishte tërhequr, bazuar në nenin 284/1 të Kodit të Proçedurës Penale, duke çuar në pushimin e çështjes penale sa i përket kallëzimit të tij, ndërsa për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" u vendos pushimi i çështjes sepse nuk u provua keqtrajtimi i shtetasit nga punonjësi i policisë.

Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor nuk ka rezultuar tejkalimi i një niveli minimal ashpërsie për t'u konsideruar trajtim çnjerëzor, por ngjarja ka ndodhur në rrugë, ambient publik, në prani të disa të njohurve që ndodheshin në makinën e tij, që mund të shkaktojnë pasoja negative psikike, por nuk ka akt ekspertimi apo veprim tjetër hetimor në këtë drejtim, duke pasur mangësi në përputhje me standartet e GJEDNj-së për kriteret e hetimit të rasteve të mundshme të torturës, trajtimit çnjerëzor apo degradues.

Në këtë çështje janë pyetur vetëm personat e përfshirë në ngjarje dhe jo dëshmitarë të tjerë që mund të ishin objektivë në deklarime, si dhe është tërhequr ankimi i punonjësit të policisë duke lënë dyshime në mirëkuptimin e palëve për të mbyllur çështjen pa hetuar plotësisht, pavarësisht *gërvishetjeve në fytyrë me mjet mbrejtës*, të konstatuara nga akti ekspertimit mjeko-ligjor. Administrimi i këtyre provave mund të rezultonte në një qasje më të arsyeshme të hetimit për pretendimet e shtetasit për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë.

- 3) Kallzuesi, shtetasi A.A. ka pretenduar se në dt. 09.05.2010, duke qënë me shoqen e tij, në momentin kur është konfliktuar me një person tjetër kanë mbërritur në vend forcat e policisë. Kallëzuesi pretendon se është keqtrajtuar nga njëri prej tyre. dhe siç del nga aktet e shqyrtuara në dosjen hetimore *nuk është konstatuar keqtrajtimi i pretenduar*. Përkundrazi, kallëzuesi është akuzuar dhe dënuar nga gjykata për fyerje për shkak të detyrës (Neni 239/1 i Kodit Penal). Kjo përbën një nga arsyet që çështja penale në ngarkim të punonjësit të policisë së akuzuar për kryerjen e veprimeve arbitrare është pushuar.

Nga vendimi gjyqësor i mëparshëm janë konstatuar shenja në kokë dhe në krahë të kallëzuesit, por janë konsideruar si pasojë e rënies së shtetasit në tokë, gjatë ndjekjes nga punonjësit e policisë, si dhe mungon një akt ekspertimi mjeko-ligjor. Mungesa e një dokumentacioni të tillë konstatues dhe deklarimeve të dëshmitarëve të tjerë, pasi ngjarja ka ndodhur në një lagje të populluar të qytetit, në

mesditë, nuk reflekton qasje të arsyeshme të hetimit për pretendimet e kallëzuesit për ushtrim dhune nga punonjësit e policisë dhe nuk ka arritur në një regjistrim të plotë të lëndimit, detyrim i caktuar nga praktika e GjEDNj-së. Në kushtet kur personi është i varur nga substancat narkotike dhe gjendja shëndetësore është relativisht e dobët, rrezikshmëria e ushtrimit të dhunës është më e lartë, për pasojë ka nevojë për veprime hetimore më të thelluara për vërtetimin e një trajtimi çnjerëzor apo degradues të mundshëm.

Kallëzimi është kryer rreth 10 muaj pas ngjarjes dhe hetimi i çështjes ka zgjatur 3 muaj, duke administruar një shkresë sqaruese e Komisariatit të Policisë, një dokument i vitit 2003 që vërteton varësinë nga substancat narkotike të kallëzuesit, një vendim gjyqësor të mëparshëm që dënon shtetasin kallëzues për “Fyerje për shkak të detyrës” për të njëjtën ngjarje, si dhe është pyetur punonjësi i policisë, i kallëzuar, më shumë se dy muaj pas nisjes së hetimit. Kjo kohëzgjatje nuk duket se justifikon veprimet e pakta hetimore, duke marrë në konsideratë konkluzionin evaziv të Prokurorisë se “*është më i besueshëm versioni i rrëzimit dhe shkaktimi shenjave nga kjo arsye, sesa ushtrimi i dhunës*”.

- 4) Tre inspektorë të INUK, në bazë të kallëzimit të paraqitur nga shtetasi R.Ç. janë proceduar për veprën e parashikuar nga neni 250, i Kodit Penal. Sipas materialeve të dosjes ka rezultuar se inspektorët kanë kryer një kontroll në vendin ku kallëzuesi (shofer i eskavatorit) po punonte në një objekt inertesh. Ai kishte refuzuar të paraqiste dokumentat por inspektorët nuk pranuan ta kishin keqtrajtuar por vetëm shtyrë për të parandaluar konfliktin që kallëzuesi kishte nisur me njërin prej tyre. Raporti i Mjekut, i kryer vetëm një ditë pas ngjarjes, nuk kishte konstatuar dëmtime trupore tek kallëzuesi, i cili pretendonte dhembje trupi dhe koke. Në këto kushte është vendosur pushimi i çështjes penale.

Hetimi ka zgjatur rreth 4 muaj, duke pasur mospërputhje me veprimet e pakta hetimore që ishin: marrja e deklarimeve të kallëzuesit, dy inspektorëve të INUK Tiranë, dy shtetasve të pranishëm në vendngjarje, si dhe administrimi i një akti ekspertimi mjeko-ligjor të kryer një ditë pas ngjarjes.

Nga akti ekspertimit dhe deklaratimet e personave të përfshirë në ngjarje, nuk është konstatuar asnjë shenjë trupore, ekimozë apo edemë tek kallëzuesi duke mos lënë dyshime për ushtrim dhune nga punonjësit shtetëror, të tillë që të tejkalojë minimumin e ashpërsisë për t’u konsideruar torturë, trajtim çnjerëzor apo degradues.

- 5) Shtetasi H.I. që vuante dënimin në burgun e Lushnjës ka kallëzuar një punonjës të burgut se ka nxitur dy të dënuar të tjerë që të ushtronin dhunë ndaj tij. Ky fakt, pas verifikimeve të kryera nuk rezultoi i vërtetë, prandaj Prokurori ka vendosur pushimin e çështjes për akuzën e parashikuar nga neni 250, i Kodit Penal.

Kohëzgjatja e hetimit është shtrirë në 7 muaj, por veprimet hetimore kanë qenë vetëm dy shkresa të IEVP Peqin lidhur me Raportet e Shërbimit të dy të dënuarve që akuzoheshin për bashkëpunim në dhunimin e kallëzuesit, pyetjen e të kallëzuarit si dhe administrimin e aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor të kallëzuesit, duke mos qenë në proporcion me qëllimin e zbardhjes së çështjes, të autorëve të mundshëm dhe identifikimin e provave në një kohë sa më të shkurtër dhe të efektshme.

Nga akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor ka rezultuar se kallëzuesi nuk vuan nga probleme mendore, ndërsa shkresat e IEVP Peqin informojnë mbi sjelljen e dy të dënuarve të tjerë në një periudhë që nuk përkon me ngjarjen e kallëzuar. Standartet e hetimit të pretendimeve për keqtrajtim nga institucionet shtetërore, të vendosura nga praktika e GjEDNj-së do të kërkonin një hetim më të thelluar, në llojshmërinë e provave të administruara dhe numrin e tyre, për shkak të lirisë së kufizuar të shtetasit kallëzues dhe pozitave të pafavorshme të tij karshi punonjësve që ushtrojnë pushtet shtetëror. Sekuestrimi i materialeve filmike apo pyetja e shtetasve të tjerë me liri të kufizuar mund të përbënin prova të administruara në një proces hetimor që ka një qasje të arsyeshme për pretendimet e shtetasit kallëzues.

- 6) Në dt. 08.11.2012, shtetësja F. B. ka bërë kallëzim penal për kryerjen e veprimeve arbitrare nga një punonjës i INUV Bashkia Elbasan. Por në dt. 15.11.2012 është regjistruar një tjetër kallëzim penal nga inspektori i INUV Elbasan dhe nga një komshi i kallëzueses, për “plagosje të lehtë me dashje” dhe “Goditje për shkak të detyrës”. Në përfundim të hetimeve ka rezultuar se punonjësi i INUV Bashkia Elbasan nuk kishte ushtruar dhunë, si rrjedhim, çështja penale u pushua.

Prokuroria ka hetuar për rreth 5 muaj duke administruar deklaratimet e personave të përfshirë në ngjarje dhe tre aktet e ekspertimit mjekoligjor, për kallëzuesen, komshiun e saj dhe inspektorin e INUV Elbasan. Kohëzgjatja e hetimit ka qenë e mjaftueshme për kryerjen e veprimeve hetimore në funksion të marrjes dhe administrimit të provave për identifikimin e rrethanave dhe autorëve të veprave penale të mundshme, por numri dhe llojshmëria e provave kanë qenë relativisht të pakta për hetimin e tre veprave penale njëherësh.

Nga akt ekspertimi mjeko-ligjor, të kryer në ditën e ngjarjes, nuk është konstatuar asnjë shenjë dhune të ushtruar mbi kallëzuesen duke bërë të mundur pushimin e çështjes së ngritur nga ana e saj. Përkundrazi, komshiu i saj dhe inspektori i INUV Elbasan kanë rezultuar të jenë dhunuar, për shkak të disa shenjave të konstatuara në trupin e tyre. Në këto kushte, ndaj shtetasës kallëzuese nuk mund të konkludohet në dyshime për ushtrim dhune që të tejkalojë nivelin e ashpërsisë për tu konsideruar torturë, trajtim çnjerëzor apo degradues, por standarti i praktikës së GjEDNj-së për një qasje të arsyeshme të hetimit, mund të plotësohet duke administruar prova të tjera, pamje filmike të mundshme duke qenë se ngjarja ka ndodhur në ambjent publik, si dhe të merreshin deklarime nga dëshmitarë të tjerë që mund të kenë qenë të pranishëm në vendngjarje. Duke marrë në konsideratë gjininë femërore të kallëzueses, veprime jo domosdoshmërisht të dhunshme fizikisht ndaj saj në ambjent publik nga shtetas të gjinisë mashkullore mund të përbëjnë elementë të trajtimit denigrues, gjë që kërkon hetim të detajuar të bazuar në disa burime për regjistrim të saktë të gjendjes shëndetësore, qoftë edhe mendore.

Nga studimi i 6 fashikujve hetimore mbi veprën penale “Kryerje e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250, i Kodit Penal, të cilat mund të përmbanin ndonjë element të torturës, trajtimit çnjerëzor, apo degradues, rezultuan se të gjitha ishin pushuar. Konkretisht:

- 1) Kallëzimet kanë ardhur nga qytetarë në gjendje të lirë apo të dënuar, që janë konfliktuar dhe kanë pretenduar ushtrim dhune nga funksionarë shtetërorë. Kohëzgjatja e hetimeve varionte nga 3 deri 7 muaj, duke pasur një shtrirje që mundësonte identifikimin dhe ruajtjen e provave dhe autorëve të dyshuar, por u konstatua disproporcion midis periudhës së hetimit dhe numrit e llojshmërisë së veprimeve hetimore;
- 2) Dhuna e pretenduar nuk është konstatuar me intensitet të lartë, me pasoja të rënda për shëndetin apo me qëllim shkaktimin tek viktimat të ndjenjës së inferioritetit, të ankthit, etj., por në rastet e kallëzuesit A.A. që pretendonte “*masakrim nga policia*” ku kishte dalë i gjakosur në foto, problemeve në lëvizje, etj., si dhe në rastet e gërvishtjeve në fytyrë të shtetasit të dhunuar nga punonjës të policisë në Cerrik apo pretendimeve të shtetasve me liri të kufizuar, vërtetimi apo jo i tejkallimit të nivelit minimal të ashpërsisë ka nevojë për veprime hetimore më të thelluara në drejtim të deklarimeve të dëshmitarëve të papërfshirë në ngjarje apo sekuestrimit i pamjeve filmike në raste të mundshme. Qenia në liri të kufizuar, gjinia femërore gjendja e

dobët shëndetësore për shkak të përdorimit të lëndëve narkotike dhe ngjarja e ndodhur në ambjent publik përbëjnë rrethana specifike, në të cilat veprime të caktuara jo domosdoshmërisht me intensitet të lartë, mund të shkaktojnë trajtim çnjerëzor apo degradues;

- 3) Qasja e arsyeshme e hetimit ndaj pretendimeve të kallëzuesit përcaktohet nga veprimet hetimore e matur në shtrirje kohore dhe rezultati i tyre. Organi i akuzës ka administruar dhe ka kryer veprime hetimore si: proces-verbale deklarimesh të kallëzuesve si dhe akte ekspertimi mjeko-ligjor për personat që pretendonin dhunën, por jo në çdo rast. Kallëzimi i shtetasit A.A. nuk është shoqëruar nga një akt-ekspertimi pasi kishte kaluar një kohë e gjatë nga ngjarja deri tek kallëzimi, pavarësisht ekzistencës së një fotoje ku kishte dalë i gjakosur dhe një vendimi gjyqësor i mëparshëm që e shpallte fajtor për “Fyerje për shkak të detyrës”, ku konstatohej problemi i tij në lëvizje dhe shenjat në kokë e në këmbë.

Këto veprime hetimore i janë deleguar në 100% të rasteve Oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe jo gjithnjë këta të fundit kanë zbatuar urdhërat e Prokurorisë (si p.sh. mos-sekuestrimi i kamerave në IEVP Peqin, për konfliktin e pretenduar nga i dënuari S.V. me tre punonjës të Policisë së Burgjeve). Në çdo çështje është konstatuar nevoja për marrjen e provave të tjera, si deklarime nga dëshmitarë të papërfshirë por të pranishëm në vendngjarje, sekuestrim pamjesh filmike apo kryerje aktesh ekspertimi të reja, për të balancuar administrimin e procesit hetimor, duke siguruar paanësinë dhe sigurinë në vendimmarrje.

- 4) Në të gjitha rastet e trajtuara më sipër është konstatuar se prokurorët kanë klasifikuar dhe interpretuar dhunën e ushtruar nga funksionarë publikë, të pretenduar nga shtetas dhe persona me liri të kufizuar, si element të figurës së veprës penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 KP, pavarësisht se në të gjitha rastet mungon fakti i pranisë së cënimit të lirisë së personit, të shkaktohet nga këto vepra penale, që përbën një element thelbësor për cilësimin juridik dhe ekzistencës së kësaj vepre penale.

- **Nga studimi i dokumentacionit gjyqësor pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan u konstatua se:**

- 1) Referuar Regjistrin të Vendimeve Penale për vitet 2011, 2012 dhe 2013 rezultoi se gjatë periudhës 2011-2013 nuk është marrë asnjë vendim penal për shkelje të neneve 86, 87, 250 dhe 314, të Kodit Penal.

Një pasqyrë e ndryshme dhe shqetësuese e realitetit shfaqet nga të dhënat e KShH-së. Në të njëjtën periudhë, Klinika Ligjore pranë KShH-së ka trajtura rreth 20 ankesa të ardhura nga IEVP Peqin, institucion në kompetencën territoriale të Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të cilat kanë pasur objekt dhunën e ushtruar në burg nga personeli, mosdhënien e shërbimit shëndetësor në raste nevojë, mbipopullimin, kushtet e këqija në burg/paraburgim, etj., të cilat potencialisht përbëjnë rrethana për shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, praktikës së GjEDNJ-së dhe nenit 86 të Kodit Penal.

- 2) Në 110 vendime në total, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kuptuar dhe zbatuar drejtë dispozitat 90 “Dëmtime të tjera me dashje” dhe 248 “Shpërdorim i detyrës” të Kodit Penal, pasi asnjë nga çështjet e trajtuara në këto vendime nuk kishte elementë objektivë dhe subjektivë të figurës së veprës penale të Torturës, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal.
- 3) Në vendimet mbi nenin 90 të Kodit Penal, subjekti aktiv dhe pasiv ishin të përgjithshëm dhe dhuna nuk tejkalonte ashpërsinë minimale që kërkon konsumimi i veprës penale të Torturës, konstatuar nga aktet e ekspertimit mjeko-ligjor. Gjendja shëndetësore dhe efektet fizike apo mendore të të dëmtuarit ishin vlerësuar deri në 9 ditë paaftësi të përkohshme në punë, pasi rezultonin tepër të lehta. Rreth 90% e çështjeve ishin pushuar për shkak të mungesës së paraqitjes të të dëmtuarit-akuzues.
- 4) Ndërsa në çështjet mbi nenin 248 të Kodit Penal, rrethanat e faktit nuk kishin të bënin me ushtrim dhune që të kishin shkaktuar gjendje shëndetësore apo efekte të rënda në shëndetin mendor dhe fizik të të dëmtuarve, por me shpërdorimin e tagrave të shtetasve zyrtarë, duke dëmtuar interesa ekonomike të shtetasve të tjerë.

III. ANALIZA E KONCEPTEVE DHE PRAKTIKAVE LIDHUR ME VEPRËS PENALE TË TORTURËS, TRAJTIMIT ÇNJERËZOR APO DEGRADUES

3.1 Analiza e disa rasteve konkrete, jashtë praktikës hetimore dhe gjyqësore të marrë në studim

Siç tregojnë dhe shifrat e mësipërme, në vendin tonë nuk ka një praktikë të zhvilluar hetimore e gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 86 e 87 të Kodit Penal. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar të arsyeshme të ndalet mbi praktikën gjyqësore në këtë drejtim në Vendimin nr. 3, dt. 11.02.2004, të saj. Ajo tërheq vëmendjen lidhur me konceptin e ngushtë që ekziston në organet e drejtësisë të vendit tonë lidhur me kuptimin e nenit 86, të Kodit Penal, duke konsideruar subjekt të këtij krimi vetëm kur ajo kryhet nga punonjës publik dhe jo nga individë (*që nuk veprojnë në cilësinë e një zyrtari*). Në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese është marrë në shqyrtim një çështje penale e shqyrtuar nga të gjitha nivelet e pushtetit gjyqësor, duke patur si objekt shqyrtimi kërkesën e parashtruar nga Gjykata e Lartë lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 86 dhe 87, të Kodit Penal (*ku bëhet përkatësisht fjalë për torturën dhe pasojat e saj*).

Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, konventave ndërkombëtare dhe praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, argumenton se, vepra penale e Torturës (*kur vërtetohet*) kryhet “*jo vetëm nga persona që veprojnë me kapacitet zyrtar por edhe jashtë këtij kapaciteti, pra edhe nga persona privatë*”. Ndalimi i torturës në kuadrin e sanksionimit të të drejtave të njeriut në aktet ndërkombëtare përbën garanci për qytetarët jo vetëm ndaj abuzimeve shtetërore por edhe ndaj abuzimeve të individëve. Ndaj është detyrë e çdo shteti që të ofrojë mbrojtje nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara nga aktet ndërkombëtare “*...pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar, jashtë kapacitetit të tillë zyrtar ose në kapacitet privat*”. Më tej ajo gjykatë e nderuar citon çështjen A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, ku GjEDNj konkludon se “*detyrimi i shteteve*

anëtare nga neni 1 i Konventës për t'i siguruar kujtdo që është nën juridiksionin e tij të drejtat dhe liritë e shprehura në Konventë e kombinuar së bashku me nenin 3 të saj, i kërkon shteteve anëtare të marrin masa të përcaktuara për të siguruar se individët nën juridiksionin e tyre nuk janë subjekt i torturës apo keqtrajtimit çnjerëzor degradues duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga individët privatë”.

Gjykata Kushtetuese konkludon se, për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimi është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdonjeri ka të drejtë për të mos iu nënshtruar torturës apo keqtrajtimeve, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individi. Detyrimi i shteteve palë në marrëveshjet ndërkombëtare për të respektuar e siguruar ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit konsiston jo vetëm në detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtimit nga zyrtarët publik, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t'i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtimit të kryer edhe nga individë.

- **Bazuar mbi një konkluzion të tillë, dështimi që mund të vihet re në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme për të siguruar një mbrojtje adekuate përbën shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.**

Lidhur me sa më sipër, herë pas here në shoqërinë tonë ndodhin ngjarje në të cilat individë të zakonshëm kryejnë veprime të dhunshme dhe të rënda ndaj individëve të tjerë, veprime të cilat mund të cilësohen si torturë apo trajtim çnjerëzor apo degradues. Në një artikull të publikuar në median e shkruar²¹ jepej rasti i një shtetasi (A. B.) i cili në bashkëpunim me të tjerë, kishte marrë peng një person, e kishte lidhur me tel dhe e kishte torturuar në mënyrë çnjerëzore sepse dyshonte se ai kishte fshehur një sasi bimësh narkotike.

Orientimi i praktikës gjyqësore vendase në drejtim të plotësimit të standarteve, të parashtruara nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në vendin tonë, lidhur me veprat e torturës dhe trajtimin çnjerëzor e degradues dikton nevojën për përshtatjen e legjislacionit të brendshëm përkatës, sepse duket se ai ka probleme, mbivendosje dhe mungesë të qartësisë së nevojshme. Gjithashtu ka nevojë për kualifikimin e punonjësve të sistemit të drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit me standartet në këtë drejtim.

Për ta vazhduar këtë analizë po ndalemi të trajtojmë një rast konkret, të trajtuar nga organet e drejtësisë, që KShH ka ndjekur. Në dt. 23.07.2013,

²¹ Gazeta Panorama e dt. 08.07.2015

shtetasi HT ka bërë një kallzim penal në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë se, babai i tij, i dëmtuari XhT, i dyshuar për kryerjen e një vjedhje, është keqtrajtuar nga dy punonjës policie të Komisarariatit të Policisë Ersekë (shtetasit E. B. dhe F. S.). Ndaj këtyre personave filloi ndjekja penale sipas nenit 250, të Kodit Penal, ndërkohë që në Aktin e Ekspertimit Mjeko-Ligjor nr. 500, dt. 23.07.2013, arrihet në konkluzionin se dëmtimet fizike të të dëmtuarit kategorizoheshin dëmtime të cilat shkaktonin paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë (nenit 90/2, i Kodit Penal). Me Vendimin e dt. 16.06.2014, të Prokurorit është vendosur pushimi i këtij procedimi penal.

Mbi interesimin tonë, në Tetor 2014, kjo Prokurori njoftoi KShH se, me vendim të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ishte shfuqizuar Vendimi "Për pushimin e çështjes", dhe se hetimet në lidhje me këtë procedim penal do të vazhdonin. Pas përfundimit të hetimeve, çështja është dërguar për gjykim me akuzën "Kryerje e veprimeve arbitrare", sipas nenit 250, të Kodit Penal.

Me Vendimin nr. 155 (26), dt. 13.01.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi deklarinimin fajtor të dy punonjësve të policisë dhe i dënoi ata me 6 (gjashtë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 406, të Kodit Penal, ajo ju zbriti atyre 1/3 e dënimit, i cili u reduktua në 4 muaj burgim për secili prej tyre. Në aplikim të nenit 63, të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim dhe, përfundimisht është vendosur detyrimi i tyre të kryejnë 60 orë në interes publik brenda dy muajve. Sjellim në vëmendje se, neni 250, i Kodit Penal, për të cilin akuzoheshin të pandehurit, parashikon dënim me gjobë ose me burgim deri në 7 vjet.

Duke analizuar aktet e gjykimit, në këndvështrimin e indikatorëve lidhur me torturën e trajtimin çnjerëzor, si dhe kriteret e hetimit e gjykimit, të përcaktuar nga GJEDNJ (shih më sipër në faqen 9-10 të këtij studimi) arijmë në konkluzionin se:

Së pari, rezulton se veprimet e kundraligjshme të të pandehurve janë kualifikuar si "Kryerje e veprimeve arbitrare", neni 250 KP, edhe pse ato nuk kanë cënuar lirinë e personit të dëmtuar, gjë që përbën një element cilësues të kësaj vepre penale. I dëmtuari ka qënë i privuar nga liria kur ndaj tij është ushtruar dhunë fizike dhe dhuna e ushtruar ka cënuar rëndë dinjitetin, integritetin fizik dhe mendor si dhe shëndetin, marrdhënie këto që mbrohen posaçërisht nga neni 86, i Kodit Penal. Provat e administruara në gjyq dhe Akti i Ekspertimit Mjeko-Ligjor nr. 500, dt. 23.07.2013, tregojnë se vepra e kryer nga punonjësve të policisë ka patur elemente të trajtimit çnjerëzor, të nenit 86, të Kodit Penal. Në Aktin e Ekspertimit thuhet: "Në trupin e shtetasit Xh. T. u konstatuan disa hematoma dhe ekimoza të formave dhe

madhësive të ndryshme si dhe në kapakët e syve të poshtëm, në pjesën e krahëve e gjoks dhe një hematomë në pjesën e gjirit të majtë. Gjithashtu, është konstatuar edhe hemoragji sklerale e anës së majtë të syrit dhe shembje e kokës dhe e trupit. 2. Dëmtimet janë shkaktuar me mjet jo të mprehtë. 3. Dëmtimet e përshkruara më lart, kategorizohen ato të paragrafit të dytë të nenit 90 të KP, dëmtime të cilat duan deri në 9 ditë". Përmbajtja e këtij Akti vërteton se viktimja është keqtrajtuar në mënyrë çnjerëzore gjatë shoqërimit të tij për në Komisariat.

Së dyti, rezulton se i dëmtuari nuk ka patur dëmtime deri në momentin që është marrë nga Komisariati i Policisë Përmet për t'u shoqëruar për në Komisariat e Policisë Ersekë. I dëmtuari është keqtrajtuar (*goditje me grushte dhe shkelma ndaj të dëmtuarit të prangosur*) sapo është marrë në dorëzim nga të pandehurit. Dhuna ka vazhduar edhe pasi i dëmtuari është futur në makinën e shoqërimit dhe gjatë rrugës për në Ersekë. Duke cituar të dëmtuarin, Gjykata pohon se, të pandehurit kanë bërë një ndalesë rrugës dhe janë futur në një lokal në Leskovik duke thënë se ai ishte personi që kishte vjedhur kafshët, duke paragjykuar të dëmtuarin me qëllim që të ulnin dinjitetin e tij tek bashkëfshatarët. Në këto rrethana gjykata duhet të orientonte hetimin gjyqësor duke zhvendosur barrën e provës tek të pandehurit, të cilët duhet të provonin se dhunën nuk e kanë ushtruar për shkak të akuzës që dyshohej se rëndonte mbi viktimën dhe situatës së tij si i ndaluar. Gjykata gjithashtu duhet të manifestonte një qasje të arsyeshme për hetimin e pretendimeve të të dëmtuarit.

Së treti, lidhur me anën subjektive, të pandehurit kanë vepruar me dashje dhe në bashkëpunim. Nuk rezulton të kenë patur ndonjë shkak ligjor për të ushtruar forcë ndaj viktimës, gjatë kryerjes së detyrës për shoqërimin e tij në komisariat. Kjo tregon jo vetëm rrezikshmëri të lartë të të pandehurve, por dhe konceptet e gabuara që ata kanë për ushtrimin e funksioneve policore, të cilat vijnë ndesh me parimet e shoqërisë dhe shtetit demokratik.

Së katërti, në rrethanat e mësipërme, caktimi i masës së dënimit përfundimtar prej 60 orë punë në interes publik, për një rast të tillë, duket se nuk përputhet me rrezikshmërinë e kësaj vepre penale dhe as me nevojën për parandalim të këtyre fenomeneve, të përhapura mjaftueshëm në vend. Në mënyrë të veçantë tërheq vëmendjen qëndrimi i prokurorit gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, i cili ka manifestuar njëanshmëri të theksuar në mbështetje të të pandehurve. Në konkluzionet përfundimtare, Prokurori është pajtuar me kërkesën e mbrojtësit të të pandehurve dhe së bashku kanë kërkuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe detyrimin e të pandehurve të kryejnë një punë në interes publik, në masën që do ta çmonte gjykata. Kjo kërkesë u pranua nga Gjykata dhe të pandehurve iu dha një dënimi i sipërcituar.

3.2 Paqartësi praktike dhe legislative lidhur me figurën e krimit të torturës

Në praktikën e punës së organeve të drejtësisë vendase rezulton se në rastet e ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj shtetasve, nga nëpunësit zyrtarë e publikë, kualifikimi i tyre sipas nenit 250, të Kodit Penal, konsiderohet si zgjedhja më e drejtë ligjore. Kjo ndodh për shumë arsye, por dhe për faktin se organet e hetimit nuk ndalen për të hetuar në mënyrë të gjithanshme dhe objektive shkakun, rrethanat dhe arsyen pse u përdorë dhuna, kohëzgjatjen e saj, veçoritë e viktimës, gjendjen e tij shëndetësore, pasojat fizike dhe psikologjike që ka pësuar, etj. Më sipër, duke trajtuar çështjet që ka rekomanduar Avokati i Popullit për vitet 2010 dhe 2011, si dhe rastet e dhunës të trajtuara në këtë studim nga praktika e punës në Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Elbasan, rezulton se **hetimi, për këto raste, ka qënë sipërfaqësor dhe jo i thelluar për të saktësuar rrethanat e plota të çështjes**. Nuk është marrë gjithë koha e nevojshme për të kryer hetimet e nevojshme, **veçanërisht për të marrë të gjitha dëshmitë që tregojnë situatën në mënyrë të paanshme**. Rezultoi se, në disa raste, **nuk është kryer ekspertiza mjeko-ligjore për të regjistruar në kohë lëndimet e viktimës**. Veprimet hetimore gjithmonë janë realizuar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, të deleguar nga Prokurori i çështjes, duke treguar nënvlerësim për ngjarje të kësaj natyre. Pra **nuk është manifestuar një qasje e arsyeshme për të verifikuar dhe hetuar me objektivitet pretendimet e të dëmtuarve**.

Jemi të mendimit se për vepra penale të torturës e trajtimit çnjerëzor, degradues janë të rrezikshme, sepse çënojnë thelbin e shtetit demokratik. Ato çënojnë jo vetëm të drejtat e shtetasit të dëmtuar, por dhe interesin publik, i cili kërkon që punonjësit zyrtarë të përmbushin detyrat e tyre në respekt të të drejtave të shtetasve. Prokurori, në këto raste, duhet të marrë të gjitha masat që hetimi i çështjes të realizohet nga persona me aftësi profesionale të mjaftueshme dhe hetimi të plotësojë standardet e përcaktuara nga praktika e GJEDNJ-së për këto vepra penale. Në raste të tilla do të sugjerohet që prokurorët, sipas rëndësisë së rastit, të ndërmarrin hetime edhe vetë, ose të ushtrojnë kontrollë, të herëpashershme, lidhur me ecurinë e hetimit të çështjeve dhe të japin udhëzime konkrete për një hetim objektiv e të thelluar, në përputhje me standardet e përcaktuara nga praktika e GJEDNJ-së.

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, **në çdo rast kur dhuna ushtrohet nga punonjësit e policisë në dëm të të shoqëruarve, të ndaluarve, të arrestuarve, të paraburgosurve dhe të personave që vuajnë dënimin me burgim, barra e provës u përket autoriteve shtetërore, ku ndodhet personi i keqtrajtuar, për të provuar që nuk është fajtor për ushtrimin e dhunës si dhe për të**

dokumentuar dhe njoftuar autoritetet kompetente për dhunën e konstatuar.²²

Gjatë monitorimit u vërejt se punonjësit e policisë, të akuzuar për ushtrim të dhunës, për t'u shfajësuar ose për të zbutur përgjegjësinë e tyre edhe pse nuk kanë mohuar veprimet e kryera, kanë pretenduar të jenë fyer nga viktimat, se të ndaluarit/arrestuarit kanë bërë rezistencë dhe nuk kanë pranuar të shoqërohen, se këta të fundit kanë qënë të parët që janë konfliktuar me policinë, etj. Pa dashur të deklarojmë se këto pretendime nuk kanë qënë të vërteta, gjatë studimit të akteve të prodhuara nga organet e drejtësisë konstatuam se këto pretendime janë pranuar apriori dhe nuk janë hetuar në mënyrë objektive. Nga ana tjetër u vu re se viktimave nuk u është krijuar mundësia e duhur për t'i kundërshtuar ose sqaruar ato pretendime të punonjësve të policisë. Mendojmë se ky është një problem që kërkon vëmendje më të madhe, si në hetimet paraprake edhe në gjykimin e çështjeve të kësaj natyre.

KShH konstaton se është krijuar një praktikë e gabuar, sipas së cilës aktet e keqtrajtimeve të raportuara, përfshirë edhe ato që kanë elementë të dukshëm të torturës, ose trajtimit çnjerëzor, ose degradues, nga ana e organeve të drejtësisë klasifikohen, pothuajse gjithmoinë, si vepra penale "Kryerje e veprimeve arbitrare", sipas nenit 250 të Kodit Penal.

Në nenin 250, të Kodit Penal, thuhet se: *"Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet"*.

Siç shihet nga përmbajtja, objekt i kësaj dispozite janë marrëdhëniet juridike që rregullojnë ushtrimin e rregullt të detyrës që të mos cënohet padrejtësisht liria e shtetasve. Pra dispozita penale është parashikuar si një masë mbrojtëse e të drejtës së lirisë vetjake, të parashikuar nga Kushtetuta. Por në praktikën e punës së organeve të drejtësisë konstatojmë se aplikimi i kësaj dispozite, në shumë raste, bëhet në mënyrë të gabuar, për raste që nuk lidhen me cënimin e të drejtës së lirisë vetjake të shtetasve. Të krijohet përshtypja se ky kualifikim i gabuar bëhet për të shmangur zbatimin e nenit 86 KP. Ky fakt u ka rënë në sy dhe organizmave ndërkombëtare, të cilat e kane cituar në raportet e tyre. Kështu, **UN CAT, në raportin e vet të vitit 2012 ka kërkuar, shprehimisht, nga autoritetet shqiptare që praktika e mësipërme të mos përdoret më.**

Përveç praktikave të diskutueshme të punës së organeve të drejtësisë, në lidhje me veprat penale të torturës, trajtimit çnjerëzor, degradues, duket se dhe legjislacioni vendas paraqet problem, të cilat duhen përmirësuar. Në nenin 86, të Kodit Penal, parashikohet se: *"Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një*

²² Shih Aksoy kundër Turqisë, të dt. 18 Dhjetor 1996, të GjEDNj

person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim: a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime; b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër; c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër; ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi; d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues; - dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet”.

Nga ana tjetër nenin 314 sanksionohet se *“Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.*

Nga sondazhet e kryera nuk kemi konstatuar që neni 314, i Kodit Penal të ketë gjetur zbatim në praktikën hetimore dhe gjyqësore të deritanishme. Nëse do të paraqiteshin raste të tilla ato do të përmbanin elemente të torturës në formën e trajtimit çnjerëzor apo dhe fyerjes së dinjitetit, sepse Kodi i Proedurës Penale, siç dihet, nuk e detyron të pandehurin të flasë, apo të bëjë deklaratë vetë-inkrimuese. Duket se përmbajtja e nenit 314 të KP përthithet plotësisht nga neni 86, i Kodit Penal. Kështu, objekti, subjekti dhe ana subjektive e këtyre veprave penale janë të njëjta dhe i vetmi ndryshim është tek ana objektive, sepse në nenin 314 nuk është parashikuar vuajtja e rëndë fizike apo mendore e viktimës, siç parashikon neni 86 KP. Nga ana tjetër dimë që neni 86 KP, pavarësisht se titullohet *“Tortura”* përfshin edhe veprime të kundraligjshme, që në aktet ndërkombëtare janë cilësuar si trajtim çnjerëzor, ose degradues. Siç kemi theksuar në fillim të këtij studimi, ku analizohen këto akte ndërkombëtare, dallimi midis torturës dhe trajtimit çnjerëzor, ose degradues qëndron tek intensiteti i dhunës së ushtruar. Në Nenin 16, të Konventën kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese, në të cilën Republika e Shqipërisë aderoi më 1993, kërkon nga Shtetet palë të parandalojnë *“veprime të tjera që përbëjnë dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, që nuk janë veprime torture, siç është përcaktuar prej saj në nenin 1, kur veprime të tilla janë kryer nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër që vepron me titull zyrtar, ose me nxitjen e tij ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur...”* Pra meqenëse Konventa nuk parashikon përkufizime për veprime që kualifikohen si *dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, lë të nënkuptohet se veprimet që nuk përfshihen në kuptimin e torturës do t’i përkasin kësaj kategorie më të lehtë.*

Për të shmangur konfuzionin e krijuar në praktikën e organeve të drejtësisë, por dhe përplasjet në legjislacionin vendas, **sugjerojmë se është me vend të rishikohen dispozitat e KP me qëllim që të trajtojnë qartazi dhe në mënyrë të veçar veprën penale të torturës dhe atë të trajtimit çnjerëzor, ose degradues (poshtërues).**

Një formulim i tillë mendojmë se do t'i shërbente një hetimi më të thelluar për të dalluar ushtrimin e dhunës që nuk kryhet në kushtet dhe elementet që kërkohen për veprën penale të torturës.

Veç kësaj legjislacioni duhet të parashikojë, më qartë, mjetet dhe rrugët ligjore të nevojshme, me qëllim që çdo shtetas që pretendon cënimin e të drejtës së parashikuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së, për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor, të ketë mundësi të mbrohet dhe të kërkojë ndërprerjen e një trajtimi të tillë si dhe dëmshpërblimin për cënimin e kësaj të drejte.

3.3 Trajtimi dhe pozicioni i veçantë i viktimës gjatë gjykimit dhe hetimit të veprave penale të torturës

Është thelbësore që autoritetet policore, të burgjeve dhe të organeve të drejtësisë të sigurojnë që të gjitha rastet e keqtrajtimin nga ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, të ndëshkohen me vendosmëri, të hetohen dhe dënohen sipas ligjit. Në këto raste dështimi për hetimin dhe ndjekjen penale efektive dhe eficiente, ose gjykimit të drejtë të akuzave për keqtrajtim kontribuon në uljen e besimit të shtetasve ndaj autoriteteve ligjzbatuese dhe në zgjerimin e fenomenit të pandëshkueshmërisë. Udhëzimet e Komitetit të Këshillit të Ministrave të KE për çrrënjosjen e pandëshkueshmërisë në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut parashikojnë që: *“Shtetet do ta luftojnë pandëshkueshmërinë duke e parë atë si çështje të drejtësisë për viktimat, si mënyrë për të frenuar cënimin e të drejtave të njeriut dhe me qëllimin që të mbrojnë shtetin ligjor dhe besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë”*.²³

Nga monitorimet që KShH ka kryer, ndër vite, në organet e drejtësisë, si dhe nga mediat është bërë e ditur se ka raste kur të pandehurit pretendojnë, gjatë gjykimit, se gjatë hetimeve paraprake janë keqtrajtuar. Janë të shumta rastet e bëra publike në media, ku ndonëse i pandehuri nuk ka parashtruar pretendime të tilla, dëmtimet e tij fizike kanë qenë tepër evidente, gjatë paraqitjes përpara gjykatës. Gjithashtu, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit kanë verifikuar shumë ankesa për keqtrajtim, kryesisht, të personave të shoqëruar nga policia, por jo vetëm dhe kanë informuar institucionet përgjegjëse shtetërore për këto situata.

Ndërsa KPT, në Raportin e vitit 2012, lidhur me gjetjet e vizitës të kryer më 2010 në Shqipëri, raporton se është njohur më shumë pretendime për keqtrajtime fizike dhe psikologjike e të dyshuarve për vepra penale, nga ana e policisë, përfshirë edhe të mitur. Pretendimet lidheshin kryesisht me keqtrajtime të

²³ Raporti i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, në vijim të vizitës në Shqipëri nga 23 deri 27 shtator 2013

kryera gjatë marrjes në pyetje me qëllim që të merrej informacion apo të pranohej fajësia. KPT ka bërë disa rekomandime mbi këtë çështje, veçanërisht mbi aksesin që personat e ndaluar/arrestuar duhet të kenë tek avokati apo mjeku, në raste të tilla, mbi njohjen e të ndaluarve me të drejtat e tyre, mbajtjen e procesverbaleve gjatë ndalimit/arrestimit dhe mbi problemet që lidhen me të mitur. Në të njëjtin raport KPT raporton mungesën e hetimit të efektshëm të pretendimeve për keqtrajtim, edhe në rastet kur këto paraqiten para një gjyqtari. Ky organizëm ndërkombëtar thekson se, **sa herë që një i dyshuar për kryerjen e një vepre penale paraqitet pranë autoriteteve gjyqësore dhe ka pretendime për keqtrajtim, këto pretendime duhet të regjistrohen në formë të shkruar, duhet të urdhërohet menjëherë kryerja e ekzaminimit mjeko-ligjor (ku të përfshihet, nëse është e nevojshme, psikiatri ligjor) dhe duhet të ndërmerren hapat e duhur për të siguruar që pretendimet të hetohen në mënyrën e duhur. Ky qëndrim duhet të mbahet pavarësisht nëse personi ka apo jo lëndime të dukshme.** Për më tepër, edhe në rastet kur nuk ka një pretendim të shprehur për keqtrajtim, autoritetet kompetente duhet të urdhërojnë ekzaminimin mjeko-ligjor sa herë që ka arsye për të besuar se personi mund të ketë qenë viktimë e keqtrajtimit. Dokumentimi i kujdesshëm dhe i përpiktë i evidencave mjekësore do të lehtësonte shumë hetimin e rasteve të mundshme të keqtrajtimit si dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve. **Nëse verifikohet ushtrimi i dhunës, atëherë duhet filluar çështja penale, edhe nëse i dëmtuari nuk e kërkon një gjë të tillë.** Mirëpo nga informacioni që parashtrajnë në këtë studim rezulton që organet e prokurorisë në Tiranë e Elbasan kanë disponuar me mosfillim të ndjekjes penale edhe në raste të akuzave për torturë e trajtim çnjerëzor e degradues.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka jurisprudencë të konsoliduar sipas së cilës, moskryerja nga ana e strukturave të shtetit e një hetimi zyrtar të efektshëm në rastet kur *“një individ ngre një pretendim të argumentueshëm për keqtrajtim serioz nga policia apo organe të tjera të ngjashme”* përbën shkelje të KEDNJ-së. Një hetim i tillë duhet të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e përgjegjësve, pa të cilin ndalimi i përgjithshëm i torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit do të ishte i paefektshëm në praktikë dhe do të çonte në pandëshkueshmëri efektive për abuzimet. Në këtë këndvështrim është e patolerueshme heshtja e prokurorit ose gjyqtarit kur u paraqitet, gjatë ushtrimit të detyrës një person nën hetim ose gjykim, në gjendje arresti dhe që pasqyron dëmtime fizike, ose psikologjike. Ky është një qëndrim që vjen hapur ndesh me plotësimin e detyrës nga ana e këtyre zyrtarëve shtetërore.

Në vendimin e vitit 2013 për çështjen *Kaçiu dhe Kotorri*, i cili, ndër të tjera (*inter alia*), përfshin edhe torturën e ushtruar nga policia ndaj ankuesit gjatë marrjes në pyetje, GjEDNJ është shprehur për shkelje të Nenit 3 të KEDNJ-së nga ana e Shqipërisë. Gjykata vlerësoi se ankuesi ishte rrahur aq brutalisht,

sa ishte dërguar në sallën e gjyqit duke u mbajtur nga oficerët e policisë. Kjo Gjykatë më tej thekson se, ndonëse autoritetet e brendshme ishin në dijeni të faktit se ankuesi ishte rrahur, prokurori nuk ndërmori asnjë hap për të hetuar pretendimet serioze dhe të përsëritura të ankuesit. Për më tepër, gjyqtari, në seancën paraprake, nuk kërkoi që të hetohej gjendja fizike, dukshëm jo e mirë, e ankuesit, megjithëse ky i fundit nuk ishte në gjendje as të qëndronte në këmbë, as të ecte.

Nga ankesat e shumta që Avokati i Popullit, KShH dhe organizata të tjera që punojnë në këtë fushë, rezulton se rastet e pretendimeve lidhur me ushtrimin e dhunës në mjediset ku mbahen e trajtohen personat me liri të kufizuar, janë të shumta. Për këtë arsye është e domosdoshme që personat që vendosen në izolim, paraprakisht, por dhe më vonë të vizitohen herë-pas-herë nga mjeku. Mund të ketë raste që t'u bëhet presion mjekëve për të mos fiksuar gjëndjen shëndetësore reale të të izoluarit. Raste të tilla (nëse vërtetohen) duhet të ndiqen me akuzën e torturës, ose në formën e trajtimeve çnjerëzore, sipas rrethanave të rasteve konkrete. Nuk mund të konsiderohen të justifikueshme pretendimet se veprimet e ndërmarra për ruajtjen e sigurisë së institucionit, ose për shkak të "rrezikshmërisë" së theksuar të personave me liri të kufizuar.

Problem tek ne ka qenë dhe mbetet mbipopullimi në burgje dhe paraburgime. Ky fenomen, gjatë vitit 2015, morri përmasa shqetësuese dhe tejkaloi masën e mbipopullimit në 30% të kapaciteteve të burgjeve dhe paraburgimeve tona. Kjo situatë shoqërohet me pasoja të dëmshme për shëndetin apo gjëndjen shpirtërore të personave me liri të kufizuar, veçanërisht të të sëmurëve, të moshuarëve, grave, të të miturve etj. Është detyrë e strukturave përkatëse të shtetit të zbusin këto fenomen, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore të mundshme, si lirim me kusht, për rastet që kanë treguar rehabilitim dhe kanë humbur rrezikshmërinë shoqërore; zbatimi më i shpeshtë i dënimeve alternative ndaj burgimit amnistinë; faljen e dënimeve; lirim për shkak se izolimi rrezikon jetën e shëndetin e personit me liri të kufizuar. Gjykatat duhet të jenë të informuara mirë për situatën në burgje e paraburgime dhe ta mbajnë parasysh atë në momentet që caktojnë masat e sigurimit dhe dënimet e të pandehurve që gjykojnë. Prokurorët dhe Gjykatat si struktura të pushtetit gjyqësor, një pushtet i rëndësishëm i shtetit tonë, duhet të kontribuojnë më mirë për plotësimin e detyrimeve që ka shteti ynë për respektimim e lirive dhe të drejtave të shtetasve, kudo që ata ndodhen. Ky ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe qëndrim i mbajtur nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. KONKLUZIONE

- Organet e drejtësisë nuk kanë kryer asnjë studim në lidhje me praktikën e hetimit dhe gjykimin të veprave penale të “Torturës” dhe Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë vendim unifikues në këtë drejtim.
- Organet e prokurorisë, veçanërisht ato të Tiranës nuk janë të hapura, sa duhet, për të mundur transparencën e veprimtarisë së tyre dhe mundësinë e njohjes me të, për nevojat e studimeve që ndërmeren në fushën penale.
- Politika penale e zbatuar nga organet e drejtësisë nuk i përgjigjet nevojave për goditje dhe parandalim, që ka aktualisht në vënd, në kushtet kur rezulton se fenomeni është i përhapur, në mënyrë të veçantë në mjedise ku trajtohen personat me liri të kufizuar.
- Organet e drejtësisë nuk kanë kuptim të drejtë mbi veprën penale të “Torturës” dhe njohuri të mjaftueshme rreth praktikës dhe standardeve të krijuara nga GjEDNJ-së në këtë fushë. Gjithashtu ata nuk kanë ndjeshmërinë e duhur lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale, të cilat ulin besimin e shtetasve ndaj sistemit dhe veprimtarisë së funksionarëve publikë.
- Rezulton masivisht që rastet e denoncuara sipas nenit 86 të KP, janë kualifikuar, në mënyrë të dyshimtë, si “Kryerje e veprimeve arbitrare”, ose “Shpërdorim detyrë”, sipas neneve 250 e 248 KP, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me mbrojtjen nga tortura, sanksionuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së. Prokurorët kanë treguar nënvleftësim ndaj këtyre veprave penale dhe në asnjë rast nuk i kanë kryer vetë hetimet.
- Hetimi, për këto raste, ka qënë sipërfaqësor dhe jo i thelluar për të saktësuar rrethanat e plota të çështjes. Shpesh nuk merret koha e nevojshme për të kryer hetimet e nevojshme, veçanërisht për të marrë të gjitha dëshmitë që tregojnë situatën, në mënyrë të paanshme. Rezulton se, në disa raste, nuk është kryer ekspertiza mjeko-ligjore për të regjistruar, në kohë, lëndimet e viktimës, ose vërehen vonesa për

kryerjen e kësaj ekspertize që ul mundësinë, ose pengon përcaktimet e sakta të lëndimeve dhe të gjëndjes shëndetësore të të dëmtuarve;

- Përgjithësisht, nuk është manifestuar një qasje e arsyeshme për të verifikuar dhe hetuar me objektivitet pretendimet e të dëmtuarve.
- Rezulton se, për veprat penale me elementë të torturës, trajtimit çnjerzor e degradues, janë dhënë masat tepër të lehta dënimi, përgjithësisht nën minimumin e parashikuar nga ligji dhe se kjo është rezultat i një konsensusi të plotë midis prokurorëve e gjyqtarëve.
- Prokurorët, në vendimet e tyre për refuzimin e ndjekjes penale dhe pushimin e ndjekjes penale, nuk citojnë qartësisht dhe nominalisht subjektet, që sipas nenit 291, paragrafi 2 dhe 329, pika 1, të K.Pr.P, kanë të drejtë të ankimojnë në gjykatë këto vendime. Kjo bën të pakontrollueshëm, si duhet, njoftimet e bëra nga prokurorët dhe krijon kushte për t'u mohuar subjekteve të interesuara në marrjen dijani për refuzimin, ose pushimin e ndjekjes penale, ose për ushtrimin e të drejtës së ankimit në gjykatë, nëse do ta çmojnë të arsyeshme.
- Legjislacioni penal nuk është i përqasur me kuptimin që GJEDNJ i ka dhënë veprave të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, si dhe nuk shtrihet ndaj subjekteve privatë që mund të kryejnë vepra penale të tilla. Gjithashtu Legjislacioni penal vendas, neni 86 dhe 87 KP, nuk është përqasur me standardin e krijuar nga Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 3, dt. 11.02.2004.
- Neni 86 i KP, pavarësisht se titullohet "Tortura" përfshin në përmbajtje edhe veprat që, sipas nenit 3 të KEDNJ-së, emërtohen trajtim çnjerzor, degradues (poshtëruës), të cilat dallojnë nga të parat për shkak të nivelit më të ulët të dhunës së ushtruar. Nga ana tjetër përmbajtja e nenit 314 të KP ka për subjekt vetëm personat e ngarkuar me kryerjen e hetimeve dhe nuk përfshin subjekte të tjera publike e privatë që mund të kryejnë veprime që kane elementët e torturës. Si konkluzion mund të themi se legjislacioni ynë nuk bën rregullim të plotë ligjor për penalizimin e të gjitha formave dhe subjekteve që kryejnë akte të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues.
- Ligji nr. 8454, dt. 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, që rregullon funksionimin e këtij organi, me rol të veçantë në mbikëqyrjen e rasteve të torturë dhe trajtimit çnjerzor, degradues, përcakton se ky institucion i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime, nëse vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, por kjo vjen ndesh me sa përcakton neni 281/1, i KPP, i cili detyron të bëjnë kallëzim të gjithë nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a shërbimit të tyre, marrin dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht.

- Legjislacioni ynë nuk parashikon as mjetet e rrugë të qarta gjyqësore për t'u mundësuar shtetasve të kërkojnë ndërprerjen e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, si dhe për të kërkuar dëmshpërblim për sa kanë pësuar.
- Situata e legjislacionit vendas, praktika e diskutueshme e punës së organeve të drejtësisë në këtë fushë dhe përhapja e fenomenit, janë indicie që tregojnë se strukturat e shtetit kanë dështuar për të siguruar një mbrojtje adekuate përbën shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

V. REKOMANDIME

- Organet e drejtësisë duhet të kryejnë studime në lidhje me praktikën e krijuara gjatë hetimit dhe gjykimin të veprave penale të “Torturës” dhe Gjykata e Lartë, mbi këtë bazë të përgatitë një vendim unifikues në këtë drejtim, për të orientuar drejt dhënien e drejtësisë në këtë fushë. Në mënyrë të veçantë kjo gjykate e nderuar duhet të orientojë drejt organet e drejtësisë lidhur me dallimet midis nenit 86 të KP dhe neneve 248, 250 e 314 KP.
- Legjislacioni, që rregullon funksionimin e organeve të prokurorisë, duhet të parashikojë dispozita që mundësojnë transparencën e veprimtarisë së këtyre organeve dhe aksesin e subjekteve që ndërmarrin studime në fushën e veprimtarisë së tyre. Prokuroria e Përgjithshme duhet të orientojë organet vartëse të jenë të hapura për bashkëpunim në këtë drejtim.
- Me qëllim që të zbatojnë një politikë të drejtë penale, në drejtim të luftimit të fenomenit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, organet e drejtësisë duhet të njihen, vazhdimisht, me raportet e organeve, kombëtare e ndërkombëtare, mbikëqyrëse në këtë fushë.
- Organet e drejtësisë duhet të trajnohen më shumë për të marrë më tepër njohuri rreth kuptimit të drejtë mbi veprën penale të “Torturës”, si dhe njohuri të mjaftueshme rreth praktikës dhe standardeve të krijuara nga GjEDNJ në këtë fushë. Gjithashtu ato duhet të rritin ndjeshmërinë lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale, të cilat ulin besimin e shtetasve ndaj sistemit dhe veprimtarisë së funksionarëve publikë.
- Në mënyrë të veçantë duhet të merren masa për të përmirësuar veprimtarinë hetimore në këtë fushë, me qëllim që ajo të kryhet në përputhje me standardet e krijuara nga GjEDNJ dhe me një qasje e arsyeshme për të verifikuar dhe hetuar me objektivitet pretendimet e të dëmtuarve.

- Duhet marrë masa për të orientuar drejtë masat e dënimit për këtë kategori veprash penale, me qëllim që ato të jenë në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore të tyre dhe të evitohet praktika masive e dënimeve nën minimumin e parashikuar nga ligji.
- Organet e Prokurorisë të marrin masa për të saktësuar përmbajtjen e akteve të tyre, lidhur me refuzimin dhe pushimin e ndjekjes penale, duke cituar qartësisht dhe nominalisht subjektet, që sipas nenit 291, paragrafi 2 dhe 329, pika 1, të K.Pr. , kanë të drejtë të ankimojnë në gjykatë vendimet e tyre.
- Të merren masa, që në kuadër të reformës në drejtësi, legjislacioni penal në këtë fushë, të përqaset me kuptimin që GJEDNJ u ka dhënë veprave të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, si dhe të shtrihet ndaj subjekteve privatë që mund të kryejnë vepra penale të tilla, siç ka orientuar Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 3, dt. 11.02.2004. Gjithashtu legjislacioni ynë të plotësohet me dispozita të qarta që të parashikojnë mjetet dhe rrugët procedurale gjyqësore, për t'u mundësuar shtetasve të kërkojnë ndërprerjen e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, në dëm të tyre, si dhe për të kërkuar dëmshpërblim për sa kanë pësuar.
- Ligji nr. 8454, dt. 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, të amendohet në pjesën ku përcakton se ky institucion **i rekomandon** prokurorisë të fillojë hetime, nëse vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, me qëllim që të unifikohet me nenin 281/1, i KPP, i cili **detyron të bëjnë kallëzim të gjithë nëpunësit publikë**, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a shërbimit të tyre, marrin dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht.
- Organet mbikqyrëse mbi organet e drejtësisë të rritin vëmendjen e tyre për t'u ndalur, me seriozitetin e duhur, mbi rastet kur prokurorët dhe gjyqtarët heshtin në situata kur i pandehuri, në gjendje arresti, ose dëshmitari, paraqitet përpara tyre me plagë e lëndime, ose i pretendon të jetë keqtrajtuar për shkak të ndjekjes penale, ose dëshmisë.
- Për të mundësuar pasqyrimin objektiv të dhunës së pësuar nga personat me liri të kufizuar sugjerojmë që: asnjë shtetas mos të sitemohet në mjediset e brendshme të institucioneve të policisë, paraburgimit, ose burgimit, pa u ekzaminuar më parë nga mjeku, pa praninë e personave të tjerë. Një kopje e aktit mjekësor t'i vihet në dispozicion shtetasit të ekzaminuar, i cili të ketë të drejtë ta kontestojë atë.

- Të shikohet legjislacioni me qëllim që gjykimet e shkurtuara (sipas neni 406 KPrP) të mos zbatohet për disa krime me rrezikshmëri tepër të lartë shoqërore, siç është tortura, si dhe të mos lejohet refuzimi i ndjekjes penale, kur një raport mjekësor ka konstatuar dëmtime fizike, ose psikologjike mbi të dëmtuarin.